

# Gjendja aktuale dhe praktikat e mira për implementimin e skemave obligative për eficiencën e energjisë dhe masat alternative

## Hulumtim Politikash



# Gjendja aktuale dhe praktikat e mira për implementimin e skemave obligative për eficiencën e energjisë dhe masat alternative

---

Autor: **Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)**

Programi: **Zhvillimi i Qëndrueshëm**

Publikimi: : **Tetor, 2020**



**Zhvillimi i Qëndrueshëm**  
Sustainable Development

## Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP) mbështetur nga GIZ. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.

Mbështetur nga:



Implemented by  
**giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Përmbajtja e këtij dokumenti, duke përfshirë opinionet e shprehura, jo domosdoshmërisht reflektojnë ato të donatorëve të INDEP, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo Bordit.

## Përmbajtja

<b>LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE</b> .....	3
<b>1. Hyrje</b> .....	4
a) Korniza aktuale ligjore në Kosovë.....	4
b) Përkufizimi i problemit.....	7
<b>2. Inkuadrimi i OEE</b> .....	8
a) Pjesët kryesore të skemave OEE.....	10
<b>3. Synimi i kursimit të energjisë në Kosovë dhe vendi i OEE-së në miksin e masave të politikave</b> ..	13
a) Kontributi i skemave për OEE kundrejt obligimit të Nenit 7 për vitin 2020 .....	13
b) Përzgjedhja e miksit efektiv dhe koherent të politikave për Nenin 7 .....	14
<b>4. Skenarët / metodat dhe modelet e biznesit për të arritur synimet e Kosovës</b> .....	22
a) Rishikimi i praktikave më të mira dhe statusi i skemave të OEE dhe masat alternative .....	22
b) Modele biznesi / skenarë për OEE-të .....	24
<b>5. PD-të dhe synimet</b> .....	26
a) Energjia: Furnizuesi kundrejt shpërndarësve .....	26
b) Diapazoni i mbulimit me lëndë djegëse.....	27
c) Sektorët e përdorimit fundor .....	27
<b>6. Masat e politikave dhe obligimet e kursimit të energjisë sipas sektorëve (disa nga masat e mundshme)</b> .....	28
<b>7. Sistemi i monitorimit, raportimit dhe verifikimit të kursimeve të energjisë</b> .....	29
<b>8. Përfundim</b> .....	30
<b>9. Rekomandim</b> .....	31
<b>10. Referimet</b> .....	33

## Lista e figurave

Figura 1: Aktorët kryesorë dhe struktura e politikave për Efiçencën e Energjisë në Kosovë .....	5
Figura 2: Konsumi përfundimtar dhe primar i energjisë për sektor në vitet 2015-2017 .....	8
Figura 3: Konsumi historik (GWh) dhe.....	8
Figura 4: Zbërthimi i kursimeve të energjisë bazuar në kursimet e shpallura sipas llojit të politikave....	14
Figura 4: Përmbledhje e ndërveprimeve sipas llojit të politikës .....	22
Figura 7: Paraqitja grafike e Modelit 1: Direkt nga PD që instalon vetë masën EE (mundësisht përmes një njësie subsidiare) .....	25
Figura 8: Paraqitja grafike e Modelit 1: Ofrimi i grantit një pale të tretë të kontraktuar nga PD për të instaluar një masë të EE.....	26
Figura 9: Konsumi përfundimtar i energjisë .....	29

## LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

AKEE	Agjencia e Kosovës për Efiçencë të Energjisë
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
OEE	Direktiva për Efiçencën e Energjisë
OEE	Skemat e Obligimit për Efiçencën e Energjisë
KPE	Kontraktimi për performancë të energjisë
KSHE	Kompania e shërbimeve energjetike
Ministria	Ministria përgjegjëse për sektorin e energjisë
MV	Marrëveshjet vullnetare
PZSE 2018-2020	Programi i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë 2018-2020
SHA	Shtetet Anëtare
VEO BERZH	Vendet e Operimit të BERZH

## 1. Hyrje

Ky dokument shërben si kornizë për drejtimin e diskutimit se si duhet të prezantohet dhe dizajnohet një skemë efektive obligative për efikasitet të energjisë (OEE) dhe masat tjera alternative. Ai përfshin përshkrimin e kontekstit të Kosovës në lidhje me OEE-në, shtjellimin e veçorive kryesore të OEE-ve, duke dhënë përkufizime, shpjegime të fushëveprimit dhe rëndësisë, si dhe opsione për t'u marrë në konsideratë. Shpjegimet në këtë dokument diskutimi mbështeten me evidenca nga OEE-të dhe masat tjera alternative të efikasitetit të energjisë në Evropë dhe gjetkë. Për më tepër, ky dokument mund të përdoret për të rritur përafrimin me Nenin 7 të Direktivës së Bashkimit Evropian (BE) për Efikasitetin e Energjisë (EED; 2012/27/EU), me të cilën vendet e BE-së dhe Palët Kontraktuese të Traktatit të Komunitetit të Energjisë (ku bën pjesë Kosova), duhet të realizojnë dhe të vendosin synim kumulativ të kursimit të energjisë për përdorimin fundor që është i zbatueshëm deri më 31 dhjetor 2020 qoftë përmes një skeme OEE, dhe/ose 'masave alternative të politikës' plotësuese. Megjithatë, dokumenti nuk pretendon se përmbajtja e këtij punimi do të sigurojë pajtueshmëri të plotë me Nenin 7; përmbajtja e këtij dokumenti diskutimi bazohet në përvojat dhe hulumtimin e praktikave të mira për implementimin e skemave obliguese të efikasitetit të energjisë dhe masat tjera alternative.

### a) Korniza aktuale ligjore në Kosovë

Kosova ka angazhim të fortë drejt integritimit në BE, dhe për këtë arsye është ndër vendet që kanë përqaftuar implementimin e kërkesave të lartpërmendura që rrjedhin nga Neni 7 i Direktivës së Bashkimit Evropian (BE) për Efikasitetin e Energjisë (EED; 2012/27/EU). Kosova u bë nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë në 2005<sup>1</sup> dhe që atëherë e nxitur nga ky zotim dhe vizioni i përbashkët i Komunitetit të Energjisë, Kosova ka zhvilluar kornizën e saj ligjore për efikasitetin e energjisë brenda sektorit të energjisë me qëllim të rregullimit të brendshëm dhe për të siguruar përmbushjen dhe respektimin e obligimeve që dalin nga traktati dhe direktivat e BE-së.

Legjislacioni primar që rregullon efikasitetin e energjisë në Kosovë është Ligji nr. 04/L-016 dhe pararendësi i tij Ligji nr. 06/L-079 për Efikasitetin e Energjisë, me të cilin përcaktohet korniza e gjerë e politikave për efikasitetin e energjisë. Ky u pasua me krijimin e Agjencisë së Kosovës për Efikasitetin e Energjisë si organ kryesor për zhvillimin dhe zbatimin e politikave të efikasitetit të energjisë, dhe Fondin e Efikasitetit të Energjisë që ka për qëllim të bëjë të mundur rrjedhën e qëndrueshme financiare në zbatimin e projektit të masave të efikasitetit të energjisë.

Në përmbushje të masave të efikasitetit të energjisë, janë miratuar një sërë aktesh nënligjore, siç është Udhëzimi Administrativ për Auditimin e energjisë; Udhëzimi Administrativ për Promovimin e efikasitetit të energjisë; Udhëzimi Administrativ për Etiketimin e pajisjeve elektrike shtëpiake - duke specifikuar masat dhe obligimet që duhet të ndërmerren brenda sektorit të energjisë. Për më tepër, në legjislacionin tjetër primar që është përpunuar dhe që ndikon indirekt në masat e efikasitetit të energjisë përfshihen Ligji nr. 03/L-185 për Zyrën e Rregullatorit të Energjisë, Ligji nr. 03/L-184 për Energjinë, Ligji për Energjinë Elektrike, Ligji për

<sup>1</sup> <https://www.mzhe-ks.net/sq/traktati-per-themelimin-e-komunitetit-te-energji-se-#X29Q12gzZPY> (qasur më 03/06/2020)

## Rregullatorin e Energjisë, Ligji për Planifikimin Hapësinor dhe Ligji për Ndërtimin.




Figura 1: Aktorët kryesorë dhe struktura e politikave për Eficiencën e Energjisë në Kosovë

Tutje, vlen të përmendet se Neni 7 i Direktivës për Eficiencën e Energjisë 2012/27/BE ka rol kryesor në realizimin e masave të BE-së që kanë për synim të arrijnë një përmirësim të eficiencës së energjisë prej 20% deri në vitin 2020. Rëndësia e Nenit 7 është ritheksuar më tej në direktivën e rishikuar të eficiencës së energjisë (Direktiva EED 2018/2002) si një instrument kryesor në realizimin e synimeve të kursimit të energjisë drejt vitit 2030 dhe më tutje. Kështu, si nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, si dhe si në rrugën e saj drejt integritimit në BE, Kosova është e obliguar të ecë përpara në praktikimin e skemave të OEE-së.

Në një qasje të ngjashme, neni 10 i Ligjit nr. 06/L-079 për Eficiencën e Energjisë (në Kosovë) artikulon se kush janë Palët e Obliguar dhe përcakton kursimet kumulative vjetore të energjisë në 0.7% (në raport me shitjen totale të energjisë), ndërsa lëndët djegëse që përdoren në transport përjashtohen nga ky ekuacion. Efekti i përjashtimit të transportit mund të inkurajojë rritjen e vazhdueshme të mobilitetit të motorizuar individual në dëm të zhvillimit të transportit publik, duke rezultuar në vëllim më të madh të lëndës djegëse të konsumuar në të gjithë vendin. Përveç imponimit të skemave të OEE për palët e obliguara, sipas ligjit të sipërpërmendur, qeveria qendrore rezervon të drejtën për të marrë masa të tjera të politikave për të arritur pjesërisht kursimet e energjisë në radhët e konsumatorëve fundorë.

Korniza ligjore primare i obligon autoritetet lokale të ndërmarrin një varg veprimesh në mbështetje të cakut kombëtar të eficiencës së energjisë, siç është zhvillimi i Planeve Komunale për Eficiencë të Energjisë (PKEE), në përputhje me udhëzimet e Agjencisë së Kosovës për Eficiencën e Energjisë (AKEE). Planet e tilla duhet të miratohen nga Kuvendi Komunal dhe t'i paraqiten AKEE-së. Komunat gjithashtu janë të obliguara të hartojnë Raportin e Progresit për zbatimin e PKEE, në përputhje me udhëzimet e AKEE. Këto raporte duhet të miratohen nga

Kuvendi Komunal dhe të dorëzohen në AKEE. PKEE të tilla tani kanë kompletuar 15 (nga 37) komuna<sup>2</sup>.

Për më tepër, institucionet e Kosovës kanë përgatitur dhe azhurnuar një sërë strategjish dhe planesh për eficiencën e energjisë, ku veçohen versioni i 1-rë, 2-të dhe 3-të i Planit Kombëtar të Veprimit për Eficiencën e Energjisë (PKVEE); Strategjia e Energjisë (2009-2018) dhe Plani i Veprimit (2010-2018); dhe Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës (2017-2026) dhe Plani i Zbatimit të saj (2018-2020).

Plani i Zbatimit të Strategjisë së Energjisë 2018-2020, i cili u përgatit bazuar në Ligjin nr. 06/L-079 për Eficiencën e Energjisë, në Vizionin e tij thekson se ka për synim 'krijimin e një sektori të zhvilluar të energjisë, i cili është i padëmshëm për mjedisin dhe shëndetin, që mbështetë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe mirëqenien sociale në Kosovë, në kuadër të një tregu të lirë dhe konkurrues të energjisë'. Ndërsa, për zbatimin e objektivit pesë (5) të PZSE 2018-2020 janë caktuar trembëdhjetë (13) masa/masa specifike dhe dyzet e një (41) aktivitete, në përmbushjen e synimeve dhe obligimeve për eficiencën e energjisë, burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit.

Për ta përmbledhur, reduktimin e energjisë primare në Kosovë e adresojnë strategjitë e mëposhtme:

- Strategjia e Energjisë e Kosovës 2009-2018
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016-2021
- Plani për Zhvillim të Qëndrueshëm, Shtyllat IV, Trajtimi i Energjisë, Analiza e Politikave/Zyra e Planifikimit Strategjik e Zyrës së Kryeministrit
- Programi i Reformës Ekonomike (PRE) 2016
- Rishikimi i financave publike të Kosovës: Politikat fiskale për një shtet të ri (2014), Raporti nr. ACS9351
- Strategjia e Ngrohjes 2011-2018
- Plani Zhvillimor i Transmisionit 2012-2021
- Plani Zhvillimor i Shpërndarjes 2010-2014 dhe 2016-2022
- Plani Zhvillimor i Ngrohjes Qendrore - Termokos
- Plani i Veprimit i Vizionit Ekonomik të Kosovës 2011-2014
- Bilanci Afatgjatë i Energjisë 2015-2024<sup>3</sup>

Por çuditërisht, pavarësisht faktit se korniza ligjore e zhvilluar ka premtuar një mori zhvillimesh pozitive, projektet e eficiencës së energjisë kanë pasur implementim aty-këtu në skenarin më të mirë, ndërsa në shumë raste janë drejtuar nga donatorët e jashtëm dhe ndihma për zhvillim. Një raport i Bankës Botërore (2016)<sup>4</sup> thekson se çmimet e rregulluara të energjisë në Kosovë kanë dëmtuar natyrën reflektuese të kostove të masave të eficiencës së energjisë dhe kështu konsiderohen si pengesa kryesore e zhvillimit të saj. Dhe, raporti i BE-së për IPA<sup>5</sup> thotë se Kosova

<sup>2</sup> Raporti Përfundimtar i Eptisa: Studimi Kombëtar i Eficiencës së Energjisë në Ndërtesa për Kosovën. 2013

<sup>3</sup> Plani i Tretë Kombëtar i Veprimit për Eficiencën e Energjisë (PKVEE) në Kosovë

<sup>4</sup> Banka Botërore 2016, Opsionet për Financimin e Eficiencës së Energjisë në Ndërtesat Publike në Kosovë

<sup>5</sup> [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/ipa\\_2017\\_040506.07\\_ks\\_eu\\_support\\_to\\_the\\_energy\\_efficiency\\_fund.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/ipa_2017_040506.07_ks_eu_support_to_the_energy_efficiency_fund.pdf) (qasur më 03/06/2020)



po mbetet prapa në implementimin e caktimit të përgjithshëm të efikasitetit të energjisë për shkak të mungesës së resurseve financiare për të investuar në masat e efikasitetit të energjisë. Kursimi i energjisë i planifikuar në Planin e Dytë Kombëtar Afatmesëm (2013-15) u zbatua me vetëm rreth gjysmën e paraparë (kursimi i energjisë i arritur në 2015 është rreth 4.4% krahasuar me 6% që kërkohet).

#### **b) Përkufizimi i problemit**

Kosova ka gëzuar rritje të qëndrueshme ekonomike në periudhën pas vitit 1999, ndër të tjera, duke rezultuar në rritje të vazhdueshme të kërkesës për furnizim me energji elektrike. Furnizimi aktual i energjisë elektrike mbështetet në dy termocentrale të vjetruara me djegje linjiti dhe planet për një impiant të ri modern me linjit, janë ndalur rishtazi<sup>6</sup>. Si pasojë, ky zhvillim i fundit ka forcuar besimin e palëve të interesuara në ndjekjen e mundësive nga burimet e ripërtëritshme dhe përfitimet e tyre plotësuese sociale, mjedisore dhe ekonomike.

Ndërsa kërkesa ka tejkaluar furnizimin, Kosova në vazhdimësi është varur nga importet e paparashikueshme të energjisë elektrike, dhe veçanërisht pasi u ndal projektin për ndërtimin e termocentralit të ri, gjë që çmohet se do të intensifikojë më tej varshmërinë nga importet e energjisë. Nga ana tjetër, gjatë muajve të verës, me gjithë ndikimet e pafavorshme mjedisore të operimit, ekziston një tepricë e dukshme e energjisë elektrike e prodhuar nga këto termocentrale me bazë linjiti, e cila eksportohet më pas në rrjetin rajonal.

Në Kosovë dimrat janë të ashpër dhe verat janë të nxehta, kështu që ngrohja dhe ftohja e shtëpive kryesisht mbështetet në një kombinim të burimeve të biomasës dhe energjisë elektrike për stinën e dimrit dhe vetëm në energji elektrike për stinën e verës. Rritja e vazhdueshme e konsumit të energjisë si për ngrohje ashtu edhe për ftohje ka pasur ndikime të pafavorshme mjedisore, ekonomike dhe shëndetësore për shkak të varshmërisë së Kosovës nga dy termocentrale të vjetruara dhe të pasigurta që djegin linjit, të cilat kanë shkaktuar përhapjen e sasive të mëdha të hirit që ndot ajrin e të gjithë vendit, ndërsa 'kodra' e hirit është e dukshme nga më shumë se 10 km largësi<sup>7</sup>. Në mënyrë të ngjashme, përdorimi i madh i energjisë elektrike për ngrohje gjatë stinës së dimrit rrit presionin në zinxhirin e vjetruar të furnizimit duke shkaktuar ndërprerje të furnizimit me energji elektrike. Si rezultat, mungesa në furnizimin me energji elektrike është cituar si pengesë kryesore për zhvillimin e biznesit në Kosovë<sup>8</sup>.

<sup>6</sup> <https://www.reuters.com/article/brief-contourglobal-says-halted-plans-to/brief-contourglobal-says-halted-plans-to-build-a-500-megawatt-coal-fired-power-plant-in-kosovo-idUSFWN2B91XB> (qasur më 03/06/2020)

<sup>7</sup> <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo/brief/al-energy-in-kosovo> (qasur më 15/06/2020)

<sup>8</sup> Banka Botërore 2016, Opsionet për Financimin e Efikasitetit të Energjisë në Ndërtimet Publike në Kosovë




Figura 2: Konsumi përfundimtar dhe primar i energjisë për sektor në vitet 2015-2017<sup>9</sup>




Figura 3: Konsumi historik (GWh) dhe kërkesa në orët e pikut (MW) në Kosovë 2000-2010<sup>10</sup>

Ndërsa si përgjigje, disa studime të bëra nga Banka Botërore, BE dhe institucionet e Kosovës kanë arritur në përfundimin që, ndër të tjera, boshllëku i furnizimit me energji do të duhej të mbulohet nga energjia e ripërtëritshme dhe masat e efijencës së energjisë. Në tetor 2018, Banka Botërore ka deklaruar se nuk do të ketë mbështetje për termocentralin me linjit në Kosovë meqë 'opsioni me kosto më të ulët' për prodhimin e energjisë është tani energjia e prodhuar nga burimet e ripërtëritshme. Ky efekt ka ardhur për shkak të zgjerimit global të përdorimit të burimeve të ripërtëritshme, ndërsa zbatimi i bazuar në energjinë solare dhe të erës mbështetet fuqimisht. Kjo në fakt premtion një skenar të energjisë me karbon të ulët për nevojat e tanishme dhe të ardhshme të Kosovës për energji.

## 2. Inkuadrimi i OEE

Skema e Obligimit për Efijencën e Energjisë (OEE) është një mekanizëm legjislativ, i obligueshëm ose vullnetar që kërkon që palët e obliguara (PD) t'i përmbushin caqet e matshme të kursimit të energjisë përmes stimulimit të investimeve fitimprurëse në efijencën e energjisë në përdorimin fundor.<sup>11</sup> Rentabiliteti i një mase investimi bazohet në shqyrtimin e kostove dhe përfitimeve të kursimeve të energjisë nga perspektiva e përgjithshme sociale. Kështu, efektiviteti i kostos nuk nënkupton se sa ekonomike është të nxjerrësh kursime me koston më të ulët, por në vend të kësaj nënkupton se shtrirja e përfitimeve të ndryshme që rrjedhin nga investimet është më e madhe sesa kostoja e plotë e atyre politikave dhe masave (qeveria, kompanitë e energjisë, dhe/ose përdoruesit fundorë).

Përveç përcaktimit të përgjegjësisë për të siguruar ndërmarrjen e veprimeve të efijencës, OEE-të ofrojnë përfitime të tilla si:

- parimi 'ndotësi paguan', meqë përdoruesit në fund paguajnë kostot e OEE-ve përmes faturës mujore që marrin nga furnizuesi i energjisë;
- reduktimi i barrës në shpenzimet publike meqë në fund të fundit financimi vjen nga përdoruesit fundorë;

<sup>9</sup> Raporti i Tretë Vjetor nën Direktivën e Efijencës së Energjisë. Agjencia e Kosovës për Efijencë të Energjisë, 2019

<sup>10</sup> Raporti Përfundimtar i Eptisa: Studimi Kombëtar i Efijencës së Energjisë në Ndërtesa për Kosovën. 2013

<sup>11</sup> Skemat e Obligimit për Efijencën e Energjisë: Udhëzime për politika. Përgatitur bashkërisht nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (redaktuar 2019)

- trasimi i rrugës drejt një perspektive të qëndrueshme që nuk është e ndjeshme ndaj luhatjeve të buxhetit publik dhe ndryshimit të vendimeve buxhetore të qeverisë;
- historiku i dëshmuar i të qenët zgjidhje më e leverdishme kur krahasohet me politikat e tjera të efijencës së energjisë<sup>12</sup>.

Sa për ilustrim, nga një Pasqyrë e Raportit të vitit 2017<sup>13</sup>, Austria kishte marrëveshje vullnetare nga 2009 në 2014; Danimarka kishte obligimin për të ofruar shërbime të këshillimit të energjisë nga vitet 1990 për shpërndarësit e energjisë elektrike dhe nga fillimi i viteve 2000 për shpërndarësit e gazit, deri në 2005; Irlanda kishte marrëveshje vullnetare nga 2011 në 2013; Lituania votoi një ligj të ri për efijencën e energjisë në nëntor 2016 duke përforcuar marrëveshjen vullnetare me kompanitë e energjisë të filluar në 2010; Sllovenia kishte marrëveshje vullnetare nga 2010 në 2014; dhe MB kishte obligimin e mjeteve (EESoP: Standardi i Performancës së Efijencës së Energjisë), nga 1994 në 2002. Në përgjithësi, OEE-të kanë funksionuar me sukses në të dy skenarët e segmenteve monopolistike dhe në tregjet e liberalizuara të energjisë. Ato kanë historik të dëshmuar brenda Evropës dhe globalisht për fleksibilitetin e tyre për t'u përshtatur me rrethanat lokale, gjë që gjithashtu vërehet si përparësia e tyre kryesore. OEE-të mund të përshtaten me tregun aktual të energjisë, qoftë ai i rregulluar apo i liberalizuar, sjelljen e palëve të obliguara, qasjet e kursimit të energjisë të përdoruesve të ndryshëm fundorë dhe gjithashtu kulturën lokale. Në këtë kuptim, mu ky potencial i fleksibilitetit që gëzojnë OEE-të është gjithashtu vështirësia kryesore të cilën ky hulumtim e ka hasur në ofrimin e rekomandimeve specifike; rrjedhimisht, dokumenti përcaktohet në ofrimin e rekomandimeve që përshtaten enkas me kushtet lokale. Megjithëse, të kesh një ofrues të energjisë me monopol në vend, siç është rasti në Kosovë, mund të kundërbalancojë rezultatet dhe përfitimet e tregut që do të nxirren nga natyra konkurruese e skemave për OEE, që zakonisht lindin në mjedise të liberalizuara.

OEE-të gjetën zbatim në nivel global me furnizuesit e energjisë elektrike dhe gazit, megjithëse kohët e fundit, ato po vendosen gjithashtu për ofruesit e formave të tjera të energjisë, për shembull, lëndët djegëse për transportin rrugor, mazuti për ngrohje, ngrohja qendrore, etj. Përvoja globale ka qenë se rrallë ndodh që të mos përmbushet caku i kursimit të energjisë.<sup>14</sup> Kjo është si rezultat i përdorimit të stimujve financiarë nëse tejkalohet synimi i kursimit të energjisë (qasje e zakonshme në Shtetet e Bashkuara) ose i përdorimit të kërcënimit apo ndëshkimeve financiare nëse synimi i kursimit të energjisë nuk plotësohet (qasje e zakonshme në Evropë). Qasja e zakonshme e identifikuar me OEE-të përqendrohet në vendosjen e synimeve të kursimit të energjisë për disa vjet, më shpesh një periudhë tre-vjeçare, deri në fund të së cilës palët e obliguara duhet të arrijnë ulje të caktuara të përdorimit të energjisë nga përdoruesit fundorë.

Si një mekanizëm i bazuar në treg, OEE-të zakonisht nuk përcaktojnë masat që duhet të instalohen. Ndërsa, PD-ve u jepet liria operacionale për të përkufizuar masat specifike dhe

<sup>12</sup> Projekti i Asistencës Rregullatore, Praktikikat më të mira në hartimin dhe zbatimin e Skemave për Obligimin e Efijencës së Energjisë, 06.2012.

<sup>13</sup> Lees, E., dhe Bayer, E. (2016, shkurt). Paketa e mjeteve për Obligimet e Efijencës së Energjisë. Bruksel, Belgjikë: Projekti i Asistencës Rregullatore. Marrë nga <http://www.raponline.org/document/download/id/8029>

metodën e tyre të zbatimit, megjithëse duke marrë parasysh udhëzimet e përkufizuara nga shteti. Si pasojë, krijohen kushte për të lejuar forcat e tregut të lirë të identifikojnë qasjen më fitimprurëse për arritjen e kursimeve të energjisë, në varësi nga konteksti lokal. Për të rritur efektivitetin në realizimin e kursimeve të përgjithshme të energjisë, OEE-të duhet të plotësohen me politika të kodeve të ndërtimit, standarde të pajisjeve shtëpiake, stimuj të përshtatshëm rregullatorë dhe me obligime për kompanitë e energjisë dhe përdoruesit fundorë. Ndërsa ia vlen të kihet parasysh se OEE-të nuk janë një mjet universal për arritjen e të gjitha caqeve të eficiencës së energjisë dhe arritjen e kapacitetit gjithëpërfshirës me kosto-efektive. Përkundrazi, ato janë një instrument me një historik të dëshmuar të realizimit efektiv të masave të eficiencës së energjisë, të paktën kur krahasohen me trendin ose skenarin e zakonshëm të biznesit.

Grupi i zakonshëm i aktorëve të përfshirë në zbatimin e skemave OEE janë qeveria qendrore, administratorët e skemës OEE, palët e obliguara dhe sektori privat. Tabela më poshtë përmbledh rolet e secilit prej aktorëve të përmendur më lart.

	QEVERIA	ADMINISTRATORËT	PALËT E OBLIGUARA <sup>15</sup>	E	E	SEKTORI PRIVAT <sup>16</sup>
<b>ROLET</b>	Vendosja e caqeve për EE Identifikimi i llojit të subjektit si PD Përcaktimi i burimeve të financimit Përkufizimi i rregullave dhe rregulloreve	Negociimi i obligimeve me PD-të Vendosja e ndëshkimeve për proceset e dështuara Monitorimi dhe verifikimi i rezultateve të EE	Menaxhimi i implementimit Komunikimi Përdoruesin fundor Garantimi i sigurimit të cilësisë Evidentimi dhe raportimi i rregullt		i me të	Levimi për shitjen e eficiencës Ofrimi i fondeve Instalimi i masave për EE

*E adaptuar nga: Wasserman, N., & Neme, C. (2012)<sup>17</sup>*

### a) Pjesët kryesore të skemave OEE

Në vijim jepen në mënyrë të përmbledhur komponentët kryesorë të një skeme për OEE dhe praktikatat më të mira që kanë dalë nga hulumtimi për t'u marrë parasysh gjatë implementimit në kontekstin e Kosovës. Përgjithësisht, për të siguruar zbatimin e skemave për OEE, ofrohen udhëzime kryesore për rregullimin e tre komponentëve të mëposhtëm: një kornizë e përshtatshme ligjore, një njësi për administrimin e skemës dhe mekanizmat realizues për zbatimin nga palët e obliguara. Së këndejmi, këta komponentë shtjellohen në më shumë detaje më poshtë.

#### Pjesa 1: Legjislacioni

Një parakusht themelor i përcaktuar është zhvillimi i kornizës ligjore që trajton skemat për OEE. Në këtë drejtim, një qasje e pranuar gjerësisht është që legjislacioni primar duhet të mbulojë përshkrimin e caqeve të skemës, përgjegjësitë e agjencive të ndryshme dhe skemat e

<sup>15</sup> Operatorët e Sistemit të Energjisë Elektrike dhe/apo energjisë termike ose kompanitë e shitjes me pakicë të energjisë dhe/ose shpërndarësit e lëndës djegëse të lëngshme të energjisë për shitësit me pakicë dhe ose që furnizojnë drejtpërdrejt lëndë djegëse për konsumatorët fundorë që veprojnë në territorin e Republikës së Kosovës sipas legjislacionit përkatës, konsiderohen Palë të Obliguar të skemës së obligimeve të eficiencës së energjisë.

Burimi: Ligji nr. 06/L-079 për Eficiencën e Energjisë, neni 10/2

<sup>16</sup> Në përgjithësi, këta janë ofruesit e shërbimeve; institucionet financiare; organizatat e komunitetit dhe/ose të tjera

<sup>17</sup> Wasserman, N., & Neme, C. (2012). Politikat për arritjen e eficiencës më të madhe të energjisë. Projekti i Asistencës Rregullatore me Energy Futures Group dhe Sleeping Lion Consulting.

Marrë nga: <https://www.raponline.org/wp-content/uploads/2016/05/sleepinglion-nemewasserman-globalproj1-final-2012-oct-16.pdf>

mundshme të shpërblimit/ndëshkimit për pajtueshmëri/mospajtueshmëri. Ndërkaq, legjislacioni sekondar mund të përdoret më pas për të ilustruar metodologjitë specifike sipas synimit, llogaritjen e kursimeve të energjisë, shkallën e normave ndëshkimore, si dhe proceset e monitorimit dhe verifikimit.

Një vëmendje e veçantë do të duhej t'i kushtohet çështjes së bazës ligjore për shqiptimin e ndëshkimeve në rast të mospajtueshmërisë që do të stimulojë PD-të për të punuar në realizim (shih Monitorimi dhe Verifikimi më poshtë). Kjo është me rëndësi për Kosovën dhe historikun e saj të implementimit aty-këtu në të gjithë politikat qeveritare, duke theksuar kështu që mospajtueshmëria do të dëmtojë shpejt besueshmërinë e skemës. Po kështu, sigurimi i kornizës ligjore dhe rregullatore që akomodon një sistem efektiv monitorimi dhe verifikimi ka rëndësi thelbësore për ruajtjen e besueshmërisë së skemës për OEE. Prandaj, një udhëzim i qartë rreth kërkesës për të ndërmarrë kontrole të domosdoshme me marrje të mostrave (si nga PD-të ashtu edhe nga administratori) për kursimet e pretenduara janë thelbësore për të fituar besimin në efektivitetin e skemave dhe për të siguruar operacione gjatë gjithë ciklit jetësor.

#### Pjesa 2: Administrata

Në mënyrë që të sigurohet që skema për OEE mbulon akreditimin, si dhe auditimin dhe monitorimin, kërkohet të zhvillohen strukturat dhe kapacitetet institucionale, metodologjitë operacionale, proceset dhe sistemet e monitorimit dhe vlerësimit. Me këtë, nënkuptohet edhe vendosja e kapaciteteve administrative të tilla si stafi i kualifikuar i përshtatur enkas për nevojat, si dhe dokumentacioni rezervë dhe mjetet që sigurojnë rrjedhën efektive të proceseve. Në përgjithësi, përgjegjësia për funksionimin efektiv të skemës për OEE zakonisht i caktohet 'Administratorit të Skemës', e cila përfshin detyrat kryesore të mbledhjes, miratimit dhe akreditimit të kursimeve të pretenduara, si dhe ndërmarrjen/drejtimin e kërkesave të lidhura me auditimin.

Ndër obligimet e 'Administratorit të Skemës' është raportimi i cili bëhet të paktën një herë në vit te qeveria, si dhe shpërndarja e informacionit mbi progresin dhe çdo sfidë që haset.

Një obligim tjetër kryesor është hartimi dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e dokumentacionit jo-legjislativ, siç janë udhëzimet rreth procesit dhe udhëzimet teknike për evidentimin dhe paraqitjen e pretendimeve, dhe ajo që është shumë e rëndësishme, mirëmbajtja e një databaze të centralizuar. Obligimi këtu mund të zgjerohet për të mbështetur PD-të me ofrimin e udhëzimeve dhe mjeteve për llogaritjen e kursimeve të energjisë. Për më tepër, 'Administratori i Skemës' është gjithashtu përgjegjës për miratimin e veprimeve të planifikuara nga PD, verifikimin e performancës në secilën fazë të skemës dhe ndërmarrjen e veprimeve të duhura të zbatimit obligues për të siguruar pajtueshmërinë.

Sapo qeveria të përcaktojë synimet e përgjithshme për OEE, administratori i skemës vazhdon me delegimin e mëtejshëm të synimeve te PD-të. Ndërsa është e rëndësishme të theksohet se vendosja e synimeve duhet të ndjekë logjikën sipas të cilës PD-të janë të obliguara proporcionalisht me hisen e tyre të tregut, për sa i përket vëllimit të energjisë që ata furnizojnë dhe/ose shpërndajnë.

'Administratori i Skemës' duhet të sigurojë që obligimet e paraqitura do të trajtojnë me kujdes

çështjen e familjeve me të ardhura të ulëta, si në mënyrën e kalimit të kostove ashtu edhe në mos-shpërfilljen e tyre në masat e efijencës së energjisë të instaluara në realitet. Mbi të gjitha, 'Administratori i Skemës' duhet të sigurojë që kostot e OEE-ve për konsumatorët fundorë dhe aktorët potencialë të tregut janë plotësisht transparente. Në këtë mënyrë, do të forcohet një qasje e ngjashme me atë të tregut për zbatimin e masave të efijencës së energjisë dhe do të shërbejë si një pikë referimi për vlerësimin e efektivitetit të kostos së OEE-ve.

Për sa i përket kostove, do të duhej të merren masa për të siguruar që komponenti i 'administratorit të skemës' nuk do të krijojë barrë për buxhetin publik. Një format standard i personelit do të duhej të përfshijë, në mënyrë të barasvlershme, një ekspert teknik me orar të plotë dhe një punonjës administrativ me orar të plotë. Ndërsa, midis obligimeve të përmendura më sipër, verifikimi i performancës së PD-ve sipas të gjitha gjasave do t'i eksternalizohet një paneli të profesionistëve të pavarur. Në fazat e hershme dhe për një kohë të kufizuar, do të nevojitet mbështetje teknike plotësuese në hartimin e rregulloreve të obliguara dhe dokumenteve udhëzuese, si dhe për logjistikën e operacioneve dhe komunikimeve. Më pas, do të duhej të merren parasysh edhe kostot rrjedhëse operationale.

Nga ana tjetër, përvoja si brenda Evropës ashtu edhe globalisht tregon se me kalimin e kohës, OEE do të krijojë përfitime financiare për përdoruesit fundorë duke ulur kërkesën e pikut dhe kostot në rrjet.

### Pjesa 3: Strukturat e realizimit për PD-të

Pasi të jetë vendosur korniza ligjore dhe 'administrimi i skemës' bëhet funksional, hapi i fundit është të mekanizmat realizues, implikimet financiare, qasja dhe metodologjitë dhe proceset e monitorimit dhe verifikimit.

Futja graduale e skemave për OEE me planifikim të kujdesshëm të fazave dhe kohë të mjaftueshme të caktuar për koordinimin midis administratorit të skemës dhe PD-ve të zgjedhura, është element kyç për të siguruar funksionimin efektiv të skemave. Në këtë aspekt, do të ishin në dispozicion koha dhe resurset e nevojshme për zgjerimin e njohurive profesionale për fazat e skemave për OEE, si dhe që kjo ide të pranohet dhe të zë rrënjë në komunitetin e PD-ve. Sigurisht, do të duhet të vendoset një mekanizëm për të bërë presion për performancë me kohë në radhët e të gjithë aktorëve.

Është pamje e zakonshme që skemat për OEE të hasin në rezistencë nga PD-të, gjë që është veçanërisht e dukshme gjatë fazës fillestare të themelimit. Kjo rezistencë është e kuptueshme duke marrë parasysh që zakonisht PD-të kanë avokuar me ngulm për rritjen e përdorimit të mallrave dhe/ose shërbimeve të tyre, që rezulton në të hyra më të larta, ndërsa tani vazhdimisht u kërkohet të zvogëlojnë dhe/ose të kufizojnë sasinë e mallrave dhe/ose shërbimeve që ato ofrojnë. Meqenëse funksionimi i skemës për OEE do të ketë implikime të mëdha financiare për PD-të dhe përdoruesit fundorë, nuk është befasuese rezistenca nga PD-të të cilat do të kenë shqetësime të mirëfillta mbi kostot që shoqërojnë skemat për OEE dhe rrezikun potencial nga vënia në pozitë të pafavorshme brenda tregut ku ato operojnë (kjo vlen për tregjet e liberalizuara).

Nga aspekti pozitiv, implikimet për PD-të në fund të fundit do të sjellin një platformë me burim

të qëndrueshëm të të hyrave dhe minimizim të riskut. Ndërkohë që ofron gjithashtu besim për sektorin privat që merret me instalimin/servisimin e masave të efijencës së energjisë për të zhvilluar biznese të qëndrueshme.

Në përgjithësi, kostot e lidhura me skemat për OEE plotësohen nga PD-të në formën e subvencioneve nga qeveria së bashku me kontributet nga përdoruesit fundorë, siç janë konsumatorët, pronarët, autoritetet lokale, bizneset, institucionet fetare dhe aktorët e tjerë. Megjithëse, do të duhej të ketë presion që kostoja e OEE-së të jetë pjesë e kostos së biznesit, ashtu si kërkesat e tjera mjedisore dhe do t'i bartet konsumatorit fundor, me pritjen që në të ardhmen hisja e tregut të energjisë do të zgjerohet më shumë dhe atëherë konkurrenca do të sigurojë që kompanitë e energjisë kryejnë obligimet e tyre me koston më të ulët të mundshme.

### **3. Synimi i kursimit të energjisë në Kosovë dhe vendi i OEE-së në miksin e masave të politikave**

#### **a) Kontributi i skemave për OEE kundrejt obligimit të Nenit 7 për vitin 2020**

Bazuar në gjetjet e fundit nga raportimi i 3-të për PKVEE-së, Kosova si nënshkruese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë ka ndërmarrë hapa që janë pranuar mirë drejt reduktimit të energjisë në sektorin primar energjetik, që është sektori i prodhimit me linjit, në gjenerimin e energjisë elektrike, në transmisionin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, në ngrohje, tarifatat dhe rregullimet e rrjetit, dizajnin dhe operacionet e rrjetit.

Neni 10 i Ligjit nr. 06/L-079 për Efijencën e Energjisë (në Kosovë) përcakton rolin e Palëve të Obliguarra dhe kursimet kumulative vjetore të energjisë në 0.7% (në raport me shitjen totale të energjisë), ndërsa lëndët djegëse që përdoren në transport përjashtohen nga ky ekuacion. Mirëpo, nuk ka asnjë provë për të demonstruar ndonjë përparim në krijimin e OEE-ve me qëllim kursimet e energjisë të theksuara në legjislacionin primar. Prandaj, është mjaft sfiduese të diskutohet vendi i OEE-ve në miksin e masave të politikave në kontekstin e Kosovës.

Nga ana tjetër, ka përvojë të madhe nga Shtetet Anëtare të BE-së që kanë aplikuar OEE-të dhe masat e tjera të politikave nga të cilat Kosova mund të mësojë. Sipas projektit të financuar nga Komisioni Evropian: Politikat e Kursimit të Energjisë dhe Skemat për Obligimin e Efijencës së Energjisë (ENSPOL), që nga viti 2015, Shtetet Anëtare të mëposhtme kanë përdorur OEE-të dhe masat alternative të politikave për të arritur obligimet e Nenit 7 për vitin 2020.

- Shtatëmbëdhjetë (17) Shtete Anëtare përdorin OEE-të (katër (4) Shtete Anëtare përdorin OEE-të si masën e vetme: Bullgaria, Danimarka, Polonia dhe Luksemburgu);
- Njëmbëdhjetë (11) Shtete Anëtare përdorin masa alternative të politikës (Belgjika, Qipro, Çekia, Gjermania, Greqia, Finlanda, Vendet e Ulëta, Portugalia, Rumania, Sllovakia dhe Suedia);
- Të gjitha Shtetet Anëtare (pos Suedia) e kanë përjashtuar transportin nga skenari bazë për llogaritjen e synimit.




Figura 4: Zbërthimi i kursimeve të energjisë bazuar në kursimet e shpallura sipas llojit të politikave<sup>18</sup>

Sipas të dhënave të raportuara nga Shtetet Anëtare, skema për OEE është instrumenti i vetëm i politikave që sjell hisen më të madhe të kursimeve të efijencës së energjisë të kërkuara me Nenin 7, me 40%. Masat e tjera të politikave pasojnë si vijon:

- skemat e financimit dhe taksat e energjisë ose CO2 me 16%;
- standardet dhe normat me 14%;
- rregullimet ose marrëveshjet vullnetare me 7%;
- masat tjera 4%;
- Fondi Kombëtar për Efijencën e Energjisë (2%), dhe
- skemat e etiketimit të energjisë (0.4%).

Siç u theksua, OEE-të mund të realizojnë një hise të konsiderueshme të kursimeve të efijencës së energjisë të një vendi sipas Nenit 7. Mirëpo, që OEE-të të realizojnë me sukses kursimet e synuara ato duhet të dizajnohen dhe të implementohen në mënyrë të saktë.

#### **b) Përzgjedhja e miksit efektiv dhe koherent të politikave për Nenin 7**

Siç u tha më herët, OEE-të janë dëshmuar për realizimin e një pjese të konsiderueshme të kursimeve të një vendi lidhur me Nenin 7. Mirëpo, mbështetja vetëm në një instrument të politikave për të realizuar kursime të efijencës së energjisë konsiderohet të jetë me risk – edhe pse disa Shtete Anëtare përdorin OEE-në si masë të vetme. Duke marrë parasysh shqetësimet në rritje të konsumatorëve që ata do t'i bartin të gjitha shpenzimet financiare të politikës, dhe nëse presioni i tillë publik dhe politik do të çonte në heqjen e politikave të efijencës së energjisë të financuara nga taksat, kjo mund të ketë një ndikim të ndjeshëm në qëndrueshmërinë e tregut të efijencës së energjisë. Përdorimi i vetëm një instrumenti të politikave nuk lejon mundësinë e shfrytëzimit të sinergjive që lindin nga instrumentet e tjera të politikave. Masat për reduktimin e karbonit që kërkohen nga Marrëveshja e Parisit ka më shumë gjasë të arrihen me aplikimin e

<sup>18</sup> Kiela Vilumsone, L., (2015, shkurt). Neni 7 i Direktivës për Efijencë të Energjisë: Gjendja aktuale. Punëtori e ENSPOL për Nenin 7 të DEE. Bruksel, Belgjikë.



një miksi koherent të politikave.

Përveç imponimit të skemave të OEE për palët e obliguara, sipas ligjit të ri, Ligji nr. 04/L-016 për Efiçencën e Energjisë, qeveria e Kosovës rezervon të drejtën për të ndërmarrë instrumente tjera të politikave për të arritur pjesërisht kursimet e energjisë në radhët e konsumatorëve fundorë. Këto mund të përfshijnë (megjithëse nuk kufizohen në) politikat e mëposhtme:

- taksat e energjisë ose të CO<sub>2</sub> që kanë efekt të reduktimit të konsumit të energjisë nga përdorimi fundor;
- skemat dhe instrumentet e financimit ose stimulimet fiskale që çojnë në aplikimin e teknologjisë ose teknikave efiçiente të energjisë dhe kanë efekt të zvogëlimit të konsumit të energjisë në përdorimin fundor;
- rregulloret ose marrëveshjet vullnetare që çojnë në aplikimin e teknologjisë ose teknikave efiçiente të energjisë dhe kanë efekt të zvogëlimit të konsumit të energjisë në përdorimin fundor;
- standardet dhe normat që kanë për qëllim përmirësimin e efiçencës së energjisë të produkteve dhe shërbimeve, duke përfshirë ndërtesat dhe automjetet, përveç në rastet kur ato janë të obligueshme dhe të zbatueshme në Kosovë;
- skemat e etiketimit të energjisë, me përjashtim të atyre që janë të obligueshme dhe të zbatueshme në Kosovë;
- trajnim dhe edukim, duke përfshirë programuesit këshillues për energji që çojnë në aplikimin e teknologjisë ose teknikave efiçiente të energjisë dhe kanë efekt të zvogëlimit të konsumit të energjisë në përdorimin fundor;

Ligji i ri për Efiçencën e Energjisë përcakton që Ministria adopton aktet nënligjore për përkufizimin e përqindjes së synimit kumulativ që arrihet përmes masave alternative dhe përqindjen që i caktohet palëve të obliguara. Deri më sot, Ministria nuk i ka adoptuar të gjitha aktet e nevojshme nënligjore që do të përkufizonin se si funksionojnë masat tjera alternative dhe kështu të kontribuojnë në synimet e kursimit të energjisë. Duke marrë parasysh mungesën e kornizës ligjore sekondare për masat alternative, raporti mbështetet në përvojat e vendeve të tjera dhe sjell përparësitë dhe mangësitë e secilës politikë.

### **Taksa e energjisë ose taksa e CO<sub>2</sub>**

Taksa e CO<sub>2</sub> përkufizohet si një instrument që përdoret për të internalizuar kostot mjedisore<sup>19</sup>. Ajo funksionon sipas parimit ndotësi paguan, duke obliguar prodhuesit dhe konsumatorët të paguajnë taksa për çdo ton të emisioneve të CO<sub>2</sub>. Taksa është dëshmuar të jetë një mjet i thjeshtë dhe me kosto efektive për të frenuar ndikimet negative klimatike - emisionet e gazrave serrë; megjithatë, shumë shtete kanë vështirësi në trajtimin e aspektit politik të vendosjes së një takse të tillë.

---

<sup>19</sup> OECD, Fjalor i termave statistikore, 2001

<b>PËRPARËSITË</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Qasja ofron stimul efektiv për të përmirësuar masat e efijencës së energjisë dhe teknologjitë e energjisë së pastër që zëvendësojnë teknologjitë ekzistuese të bazuara në karburantet fosile.</li> <li>• Ajo inkurajon alternativat për lehtësimin e kalimit nga ekonomia e bazuar në fosile në energji të pastër.</li> <li>• Të hyrat e gjeneruara nga taksa mund të përdoren për të subvencionuar burimet dhe nismat alternative të energjisë.</li> <li>• Taksa rrit vetëdijen e publikut për ndikimet e pafavorshme të emisioneve të gazrave serrë duke i obliguar prodhuesit dhe konsumatorët të paguajnë kostot sociale dhe të kapërcejnë konsumin e tepërt të energjisë – të reduktojnë kërkesën për energji.</li> <li>• Taksa është dëshmuar të jetë një mjet i suksesshëm meqë shumë vende kanë raportuar ulje të konsiderueshme të emisioneve të CO<sub>2</sub> pas prezantimit të politikës.</li> </ul>
<b>MANGËSITË</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Standardi aktual i nivelit të ulët të karbonit prej 30 EUR për ton CO<sub>2</sub> nuk është i mjaftueshëm për të frenuar dëmtimet klimatike dhe nuk mund të përmbushë objektivat e vendosura nga Marrëveshja e Parisit.</li> <li>• Struktura aktuale e taksave të shumë vendeve të BE-së nuk është e harmonizuar siç duhet me të gjitha profilet e ndotjes së burimeve të energjisë: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Në të gjitha 44 vendet e OECD-së, thëngjilli ka një normë mesatare efektive të taksës së karbonit afër zeros, edhe pse është një nga lëndët djegëse fosile më ndotëse.</li> <li>○ Tetëdhjetë e pesë për qind e emisioneve të CO<sub>2</sub> të lidhura me energjinë ndodhin jashtë sektorit të transportit. Taksat mbulojnë vetëm 18% të këtyre emisioneve, duke lënë një taksë zero për 82% të emisioneve që mbeten dhe nuk lidhen me transportin. Vetëm Danimarka, Vendet e Ulëta, Norvegjia dhe Zvicra, tatojnë emisionet që nuk lidhen me transportin me më shumë 30 EUR për ton mesatarisht<sup>20</sup>.</li> </ul> </li> <li>• Politika mund të stimulojë evazionin fiskal - kompanitë ndotin ilegalisht për të shmangur tatimet.</li> </ul>

### Rregullimet e marrëveshjeve vullnetare

Sipas raportit të përgatitur nga The Policy Partners dhe SQ Consult, Marrëveshjet Vullnetare “konsiderohen si një kontratë midis qeverisë dhe industrisë ose synime të negociuara me zotime dhe programe kohore për të gjitha palët pjesëmarrëse.” MV-të shihen si veprime të ndërmarra nga aktorë të ndryshëm që kolektivisht shkojnë përtej kërkesave rregulatore të efijencës së energjisë. Në shumicën e vendeve, MV-të konsiderohen të veprojnë si një mjet i mëvetësishëm i politikave me pak mbi-vendosje me instrumentet rregulatore<sup>21</sup>. Raporti mbështetet në përkufizimin e vendosur nga Agjencia Ndërkombëtare e Efijencës (1997) për

<sup>20</sup> OECD, Taksat për përdorimin e energjisë, 2019

<sup>21</sup> Efektiviteti i Marrëveshjeve Vullnetare të Efijencës së Energjisë, Raporti Përfundimtar. Frank Klinckenberg (The Policy Partners) Mirjam Harmelink (SQ Consult). 2017

MV-të, dhe pasqyron praktikat aktuale dhe efikasitetin e politikës në arritjen e kursimit të energjisë përmes pajisjeve shtëpiake dhe pajisjeve tjera.

<b>PËRPARËSITË</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• MV-të konsiderohen të jenë mjet efikas i politikave kur ka nevojë për veprime të politikave dhe rregullimet aktuale nuk janë mjaft praktike për ta arritur këtë.</li> <li>• MV-të me elementët e duhur thelbësorë mund të mbështesin politikëbërësit në arritjen e objektivave kombëtare për kursimin e energjisë.</li> <li>• MV-të mund të përdoren në mënyrë që kompanitë industriale të përfitojnë sepse atyre u jepen stimuj financiarë, p.sh. ulja e taksës së energjisë.</li> </ul>
<b>MANGËSITË</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Sfida është të mbahet një ekuilibër i mirë i përfitimeve midis kompanive pjesëmarrëse, kostove të pjesëmarrjes dhe uljes së përfitimeve për kompanitë.</li> <li>• Sfidë për të mbajtur një ekuilibër të mirë i përfitimeve midis qeverisë dhe kompanive pjesëmarrëse.</li> </ul>

### Skemat e etiketimit të energjisë

Etiketat e energjisë u prezantuan për herë të parë në të gjithë Evropën për një numër të pajisjeve shtëpiake në vitet '90. Politika çmohet se gjeneron kursime të konsiderueshme me kosto efektive. Aktualisht, skema ka një shkallë krahasuese vlerësimi për performancën e energjisë së pajisjeve shtëpiake nga A, duke qenë më eficiente, në G, duke qenë më pak eficiente, që është e zbatueshme për 25 kategori të pajisjeve shtëpiake. Politika ndihmon konsumatorët të zgjedhin midis produkteve duke marrë parasysh performancën e eficientës së energjisë dhe inkurajon prodhuesit të jenë më novatorë në fabrikim<sup>22</sup>.

Që nga viti 2019, janë ri-etiketuara 6 grupe produktesh të pajisjeve shtëpiake: 1) enëlarëset; 2) rrobalarëset dhe rrobalarëset-rrobatharëset; 3) frigoriferët, përfshirë frigoriferët e magazinimit të verës; 4) llambat; 5) ekranet elektronike, përfshirë monitorët e televizorëve dhe ekranet e sinjalistikës digjitale; dhe 6) frigoriferë komercialë.

Për më tepër, BE-ja prezantoi një rregullore plotësuese, për eko-dizajn, me qëllim plotësimin e politikës për etiketimin e energjisë. Mjeti i prezantuar rishtas kërkon që prodhuesit të zbatojnë standardet minimale: përdorimi i energjisë nga pajisjet kur ato nuk janë në funksion (modaliteti i gatishmërisë), volia e mirëmbajtjes, si dhe qasja mjaft e lehtë e konsumatorëve në pjesë këmbimi. Përveç mbështetjes së synimeve të kursimit të energjisë, kërkesat e eko-dizajnit gjithashtu kontribuojnë në realizimin e riciklimit të mbeturinave dhe konceptit të ekonomisë qarkore<sup>23</sup>. Të dy mjetet bazohen në Direktivën e Eko-Dizajnit dhe Etiketimit të Energjisë, siç përcaktohet nga Komisioni Evropian.

<sup>22</sup> [https://ec.europa.eu/info/energy-climate-change-environment/standards-tools-and-labels/products-labelling-rules-and-requirements/energy-label-and-ecodesign/about\\_en](https://ec.europa.eu/info/energy-climate-change-environment/standards-tools-and-labels/products-labelling-rules-and-requirements/energy-label-and-ecodesign/about_en). Qasur më 05/06/2020

<sup>23</sup> [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/e%2Bn/MEMO\\_19\\_1596](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/e%2Bn/MEMO_19_1596). Qasur më 05/06/2020

<b>PËRPARËSITË</b>	<p>Politika është dëshmuar si mjet shumë i suksesshëm i kursimit të energjisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Sipas vlerësimeve të Komisionit të Brendshëm (Komisioni Evropian), kursimet fundore totale vjetore të energjisë me sistemin e ri të etiketimit deri në vitin 2030 llogariten në 38TWh/vit, ekuivalente me konsumin vjetor të energjisë elektrike të Hungarisë.</li> <li>• Rregullorja e re e dizajnit ekologjik pritet të rritë kursimet e energjisë deri në vitin 2030 në nivelin 94 TWh/vit, ekuivalente me konsumin vjetor të energjisë elektrike të Belgjikës dhe Luksemburgut.</li> </ul>
<b>MANGËSITË</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Dizajni aktual i faqosjes së etiketave nuk lejon krahasimin e lehtë me modelet e tjera të ngjashme të produkteve në treg dhe për këtë arsye kufizon efektivitetin e tyre, që varet shumë nga ajo se çka dhe si u paraqitet konsumatorëve.</li> <li>• Direktiva e Eko-dizajnit përqendrohet posaçërisht në konsumin e energjisë në fazën e përdorimit, duke shpërfillur kështu ndikimin mjedisor të të gjitha fazave të tjera të ciklit jetësor të produkteve.<sup>24</sup></li> </ul>

### Standardet dhe normat

Këto janë masa të politikave të vendosura nga SHA-të me qëllim përmirësimin e efijencës së energjisë së (për shembull) produkteve, shërbimeve, ndërtesave dhe automjeteve. Në kuadër të këtyre skemave, palë janë ‘autoritetet publike zbatuese’. Standardet dhe normat shihen si një mjet për heqjen nga tregu të opsioneve jo-efijente të energjisë. Kjo politikë shërben për të mundësuar funksionimin e politikave të tjera të efijencës. Pa standarde dhe norma për matjen e efijencës së produkteve, shtëpive, materialeve izoluese, etj., shumica e instrumenteve të politikave nuk do të mund të funksiononin. Prandaj, ato nuk janë edhe aq plotësuese sa janë themelore për të gjitha instrumentet e politikave. Standardet dhe normat ndihmojnë të sigurohet që cilësia e teknologjive të adoptuara është e lartë, rritin transparencën dhe besueshmërinë, si dhe ulin asimetritë e informacionit, që nga ana tjetër ulin koston e transaksioneve<sup>25</sup>.

Kosova ka adoptuar tri rregullore në fund të vitit 2018 që kanë të bëjnë me kërkesat minimale për efijencën e energjisë në ndërtesa:

- Rregullore për kërkesat minimale për performancën energjetike të ndërtesave;
- Rregullore për procedurën e certifikimit të performancës energjetike të ndërtesave;
- Rregullore për metodologjinë kombëtare për kalkulimin e performancës së integruar energjetike të ndërtesave.

<sup>24</sup> Russo, A. C., Rossi, M., Germani, M., & Favi, F. (May, 2018). Direktiva e Etiketimit të Energjisë: kufizimet aktuale dhe udhëzimet për përmirësim. Konferenca e 25-të e CIRP për Inxhinierinë e Ciklit Jetësor, maj 2018, Kopenhagë, Danimarkë.

<sup>25</sup> Politikat e kursimit të energjisë dhe skemat e Obligimit për Efijencën e Energjisë, D5.1 Kombinimi i Obligimeve për Efijencën e Energjisë dhe politikat alternative

<b>PËRPARËSITË</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Standardet minimale të efiçencës mund të jenë një mjet i përshtatshëm për zvogëlimin e kërkesës industriale për energji, meqë ato adresojnë pengesat kryesore për adoptimin e masave me kosto efektive të efiçencës së energjisë në industri: shmangia e riskut dhe pasiguria.<sup>26</sup></li> <li>• Standardet dhe normat kanë ndikim përforcues në të gjitha masat e tjera të politikave.</li> </ul>
<b>MANGËSITË</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Meqenëse proceset industriale mund të jenë shumë specifike sipas (nën)sektorëve, përcaktimi i standardeve mund të jetë sfidues;</li> <li>• Kombinimet e instrumenteve të politikave që ofrojnë stimuj financiarë janë më problematike dhe efektet e pritshme po zbehen.</li> </ul>

### Skemat dhe instrumentet e financimit ose stimujt fiskalë

Në Kosovë, ekziston një sërë skemash dhe instrumentesh financiare që ofrojnë financim të projekteve dhe huadhënie për të zbatuar programe të efiçencës së energjisë. Një numër i madh i këtyre skemave financiare ofrohen me fonde nga agjencitë donatore që veprojnë në Kosovë (Banka Botërore, BERZH, GIZ, USAID, BE, etj.). Deri më tani, shumica e skemave financiare të zbatuara në vend kanë financuar programe të efiçencës së energjisë vetëm për ndërtesat publike.

Kosova ka përvojë të kufizuar në trajtimin e modeleve të ndryshme financiare, prandaj ky punim shqyrton disa nga përvojat ndërkombëtare. Raporti i Bankës Botërore mbi opsionet e financimit të efiçencës së energjisë për ndërtesat publike ka identifikuar tri modele të përshtatshme financiare<sup>27</sup>.

1. Financimi buxhetor me rikuperim të kapitalit. Modeli bazohet në metodën e kapjes së kursimeve të energjisë. Ministria ofron fonde për investime në EE dhe rikuperon kostot duke ulur shpenzimet anësore buxhetore në të ardhmen – që nënkupton buxhete të reduktuara për faturat e energjisë të agjencive buxhetore në vitet e ardhshme.

<b>PËRPARËSITË</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Modeli funksionon mirë për nivelin qendror dhe lokal, sepse nuk ekziston risku i mospagimit dhe është i lehtë për zbatim. Komunitetet mund të angazhohen me një model të tillë edhe nëse nuk kanë histori kreditore.</li> <li>• Nuk kërkon ndonjë investim nga agjencitë publike.</li> </ul>
<b>MANGËSITË</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kërkon pjesëmarrje aktive të ministrisë përgjegjëse dhe krijimin e një mekanizmi të veçantë për menaxhimin e modelit.</li> <li>• Nuk ka asnjë garanci se modeli do të funksionojë në mënyrë të qëndrueshme.</li> </ul>

<sup>27</sup> Banka Botërore. (shtator 2016). Evropa dhe Azia Qendrore: Dokumentet mbi Opsionet e Financimit të Efiçencës së Energjisë për Kosovën.

2. Fondi i Efiçencës së Energjisë (FEE) është një institucion i pavarur financiar që përdor fonde publike për të ofruar financim për projektet publike të efiçencës së energjisë. Ligji për Efiçencën e Energjisë në Kosovë tashmë ka krijuar FEE-në si instrument dhe ka përcaktuar të gjitha hapat e nevojshëm se si të vihen në funksion mekanizmi. Mirëpo, vënia në pah e përparësive dhe mangësive të politikës do të ndihmojë drejtimin e diskutimit në procesin e zbatimit të kërkesës ligjore.

<b>PËRPARËSITË</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Do të adresojë nevojat e të gjitha agjencive publike</li> <li>• Një platformë e mirë për të prezantuar Kontratat e Performancës së Kursimit të Energjisë (KPKE) dhe industrinë e KSHE-ve</li> </ul>
<b>MANGËSITË</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Modeli mund të ketë nevojë për vendosjen e një mekanizmi të sigurisë pagesave për të siguruar pagesat për shërbimet</li> <li>• Modeli aktual parashikon investime vetëm në ndërtesat publike, ndërsa sektori i banimit ka hisen më të madhe të konsumit të energjisë në Kosovë</li> </ul>

3. KSHE-të janë kompani të specializuara të shërbimeve energjetike duke filluar nga instaluesit e pajisjeve, ndërmarrjet e ndërtimit, ndërmarrjet e ngrohjes, auditorët deri te vlerësuesit e ndërtesave. Ligji për EE lejon që KSHE-të të themelohen si subjekte të regjistruara në ministrinë përkatëse përgjegjëse për regjistrimin e bizneseve. Ligji mori një qasje pak më ndryshe nga rekomandimi i raportit të Bankës Botërore. Raporti rekomandoi të shkohej me krijimin e Super KSHE-së, si institucion publik. Megjithëse, ligji parasheh një sërë kushtesh që drejtojnë mënyrën se si mund të themelohen dhe të funksionojnë KSHE-të, punimi vë në dukje disa nga përparësitë dhe mangësitë e modelit.

<b>PËRPARËSITË</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Një mjet i mirë për të zhbllokuar potencialin e kursimit të energjisë në treg</li> <li>• Tregu mesatar i KSHE-ve në BE është duke shënuar rritje të qëndrueshme</li> <li>• Potenciali për krijimin e vendeve të punës punë në sektorin e energjisë</li> </ul>
<b>MANGËSITË</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Politika që rregullon zhvillimin e tregut të shërbimeve energjetike është dëshmuar si mjaft komplekse, në nivel global.</li> <li>• Në shumë vende, ofruesit lokalë të shërbimeve energjetike mund të jenë aktorët kryesorë në procesin e zhvillimit të tregut të shërbimeve energjetike dhe kështu është mjaft e rëndësishme të kuptohet se si stimulohet procesi i zbatimit.</li> </ul>

### Trajnimi dhe edukimi

Trajnimi dhe edukimi, përfshirë programet këshilluese të energjisë, konsiderohen si domosdoshmëri në të gjithë skenarët e mundshëm të përpilimit të politikave. Duke llogaritur në mbështetjen nga Neni 7 i Direktivës së BE-së, si dhe në legjislacionin primar të Kosovës, politika e trajnimit dhe edukimit duhet të sigurojë rrjedhë të vazhdueshme të njohurive teknike

dhe certifikimit të përshtatshëm brenda sektorit që kanë për efekt zvogëlimin e konsumit të energjisë në përdorimin fundor.

Kosova ka përvojë në këto praktika, meqë Komisioni për Certifikimin e Auditorëve dhe Menaxherëve të Energjisë (KCAME) u themelua në 2012 duke u konsideruar si një mjet thelbësor për përmbushjen e synimeve të efijencës së energjisë. Duke vepruar nën ministrinë përkatëse të linjës, qëllimi i tij kryesor është të ofrojë ekspertë të trajnuar mirë dhe të kualifikuar, si dhe të bëjë certifikimin e tyre. Në Kosovë kishte 52 auditorë të trajnuar dhe të certifikuar të energjisë, ndërsa si pjesë e Projektit u bë auditimi i energjisë me porosi.

Në këtë drejtim, gjatë 2009/10 u zhvilluan 65 auditime të energjisë të porositura nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian. Ky projekt u pasua nga masat e EE-së në 63 shkolla dhe në spitale në nivelin lokal. Masat e kursimit të energjisë në këto ndërtesa përfshinin: izolimin e mureve, ndërrimin e dritareve, izolimin e kulmeve dhe bodrumeve dhe instalimin e ndriçimit me EE. Të gjitha auditimet e energjisë u kryen në ndërtesat publike (si në nivelin qendror ashtu edhe në atë lokal). Dhe, së fundmi, një program ‘Trajnimi i trajnerëve’ për auditorë të energjisë është zbatuar në 2019<sup>28</sup>.

### **Ndërveprimi midis politikave**

Shqetësimi kryesor i Shteteve Anëtare është se cilat politika mund të plotësojnë njëra-tjetrën dhe kështu të krijojnë një miks koherent të politikave. Siç u tha më lart, një numër i madh i Shteteve Anëtare tashmë po aplikojnë një sërë masash për të arritur synimet e kursimit.

Gjatë procesit të përzgjedhjes së një miksi koherent të politikave është me rëndësi të madhe të kuptohet çështja e ndërveprimeve të politikave, veçanërisht kur planifikohet futja e një skeme për OEE në politikat ekzistuese, ose një OEE dhe politika të reja njëkohësisht, siç është rasti në Kosovë. Arsyeja kryesore është se ndërveprimet e politikave ndodhin midis dy e më shumë politikave që synojnë sektorë të ngjashëm.

Ekipi i ENSPOL ka bërë një analizë të ndërveprimit të politikave brenda Shteteve Anëtare të BE-së. Analiza është bërë duke përdorur hulumtime të literaturës dhe duke marrë parasysh opinionet e ekspertëve. Tabela më poshtë do të ndihmojë nisjen e një diskutimi më të gjerë ndërmjet politikëbërësve dhe ekspertëve për përzgjedhjen e miksit më të mirë të politikave – siç përcaktohet nga ligji i ri për efijencën e energjisë. Analiza ka përcaktuar përkufizime për tri ndërveprime të mundshme midis politikave<sup>29</sup>:

- 1) Kombinimet plotësuese japin më shumë rezultate në kursime sesa politikat në mënyrë individuale;
- 2) Kombinimet asnjëse japin rezultat njëloj si politikat në mënyrë individuale;
- 3) Kombinimet me mbi-vendosje japin më pak rezultat sesa politikat në mënyrë individuale.

<b>Lloji i politikës</b>	<b>Ndërveprimi me politikat e tjera</b>
Obligimet për Efijencën e Energjisë	<u>Mbi-vendosje</u> me rabat tatimor, grante, hua dhe financim faturor. Neutrale ose komplementare me politikat e tjera.

<sup>28</sup> Raport i auditimit jo ligjor, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. 2015

<sup>29</sup> ENSPOL (shtator, 2016). Politikat e kursimit të energjisë dhe Skema e Obligimit për Efijencën e Energjisë. Raport Përfundimtar.

Rregulloret	<u>Neutrale</u> ose <u>komplementare</u> me të gjitha politikat përveç marrëveshjeve vullnetare.
Marrëveshjet vullnetare	<u>Neutrale</u> ose <u>komplementare</u> me të gjitha politikat, përveç OEE dhe rregulloreve.
Taksa e energjisë ose taksa e CO <sub>2</sub>	Gjithmonë <u>komplementare</u> .
Standardet dhe normat	Gjithmonë <u>komplementare</u> .
Skemat e etiketimit të energjisë	Gjithmonë <u>komplementare</u> .
Informacion, këshilla, informacion kthyes për faturimin, matja inteligjente	Gjithmonë <u>komplementare</u> .

Figura 5: Përmbledhje e ndërveprimeve sipas llojit të politikës<sup>30</sup>

## 4. Skenarët / metodat dhe modelet e biznesit për të arritur synimet e Kosovës

### a) Rishikim i praktikave më të mira dhe statusi i skemave të OEE dhe masat alternative

Për shkak të zbatimit të përhapur të skemave për OEE në nivelin global, identifikimi i përvojave është punë e lehtë, megjithëse modelet e identifikuara dolën me shkallë të ndryshme të suksesit. Në mënyrë shpjeguese, kapitulli në vijim përmbledh disa nga mësimet e marra nga zbatimi i suksesshëm në mbarë rajonin dhe në nivelin global në një përpjekje për të lehtësuar rrugën e Kosovës drejt vendosjes dhe zbatimit të skemave për OEE.

Ndërsa vlen të përmendet se skemat për OEE kanë funksionuar në mjaft vende anëtare të BE-së edhe para prezantimit të Direktivës së BE-së për Eficiencën e Energjisë. Më konkretisht, dhe në mënyrë aktive deri në 2013 – në Danimarkë, Francë, Itali dhe MB<sup>31</sup>. Secila prej këtyre skemave shtetërore ka rritur synimet e kursimit të energjisë që duhen arritur, duke bërë ndërkohë gjithashtu vlerësimin e progresit dhe duke ndryshuar rregullat e skemës për të përmbushur ndryshimin e objektivave dhe rrethanave. Ky vetëm sa forcon argumentin që me Nenin 7 të Direktivës së BE-së është adoptuar një qasje e politikave që tashmë është vënë në funksion dhe testuar.

Skemat për OEE me përvojën më të gjatë janë ato nga MB dhe Danimarka, të dyja në funksionim për më shumë se 25 vjet. Në MB, aplikimi i skemave për OEE e ka zanafillën në 1994 kur qeveria kombëtare vendosi obligime të eficiencës së energjisë për furnizuesit e energjisë. Furnizuesve iu lejua të faturonin konsumatorët shtëpiakë dhe NVM-të në mënyrë që të përmbushnin objektivat e kursimit të energjisë. Nga viti 2002 e tutje, NVM-të u hoqën nga skema, gjë që paraqet qasje tërësisht unike brenda BE-së. Ndërsa ndër vite, skema i është nënshtruar ri-strukturimit dhe objektivat, masat, kursimet, kostot dhe mekanizmat e saj kanë ndryshuar me kalimin e kohës në afërsisht çdo 3 vjet. PD-të janë 15 furnizues të energjisë elektrike dhe gazit,

<sup>30</sup> ENSPOL, Raporti Përfundimtar, 2016

<sup>31</sup> Skemat për obligimin e eficiencës së energjisë: e ardhmja e tyre në BE. Tina Fawcett & Jan Rosenow & Paolo Bertoldi. 2018. Në dispozicion këtu: <https://link.springer.com/article/10.1007/s12053-018-9657-1>, qasur në 18/06/2020



të cilëve u është lejuar të zbatojnë aktivitetet e tyre dhe/ose të angazhohen në partneritet me palë të treta (siç janë shoqatat e banimit social, shitësit me pakicë, prodhuesit, etj.) me qëllim realizimin e projekteve.

Në mënyrë të ngjashme, në Danimarkë skemat për OEE janë vënë në zbatim që nga fillimi i viteve 1990 me skemën që mbulonte ekonomitë familjare, industrinë, tregtinë dhe sektorin e shërbimeve dhe sektorin publik, ndërsa nga viti 2000 e tutje, në skemë u përfshinë edhe kompanitë e shpërndarjes së gazit. Me bashkimin e ndërmarrjeve të ngrohjes qendrore dhe të naftës në vitin 2006, nga viti 2006 u vendosën kushte më kërkuese të performancës. Ndërsa, rishtazi është vendosur një objektiv për 2015-2020 ekuivalent me kursimin e 3% të energjisë totale në Danimarkë (me përjashtim të transportit)<sup>32</sup>. Në përgjithësi, ekonomitë familjare përbëjnë 30% të kursimit të energjisë, rreth 20% e kursimeve arrihen në sektorin e shërbimeve (publike dhe private) dhe 1% në transport. Shpërndarësit e energjisë (gazi natyror, energjia elektrike, ngrohja qendrore dhe nafta) emërohen si PD, duke mbuluar të gjithë sektorët e përdorimit fundor (përveç transporteve). Për më tepër, PD-të mund të aranzhojnë kontrata me kontraktues të tjerë (konsulentë, tregtarë të energjisë, skuadra teknike të zanatçinjve, instalues, etj.) që do të implementojnë projekte për përdoruesit fundorë.

Më afër rajonit tonë, Sllovenia, ku është në fuqi Neni 7 i Direktivës së BE-së, ka dhënë shembull të mirë për t'u ndjekur me qasjen e tyre të ndërtimit hap pas hapi të 'Eko Fondit' ekzistues të nacionalizuar që financoi aktivitetet e eficiencës së energjisë duke bërë ngritjen e fondeve me tatim. Kjo infrastrukturë tashmë në veprim, mundësoi tranzicionin e papenguar në një skemë për OEE që funksionon. Me rreth 70% të kursimeve të energjisë në vitin 2015 që rrjedhin nga tri lloje të ndërhyrjeve: aditivët e karburantit në transport, aplikimi i sistemeve të menaxhimit të energjisë në industri dhe rinovimi i nën-stacioneve të ngrohjes në ngrohjen qendrore. Ata kanë vendosur PD që janë ofrues të ngrohjes/ngrohjes qendrore, energjisë elektrike, gazit natyror dhe lëndëve djegëse të lëngshme dhe të ngurta për konsumatorët fundorë në të gjithë sektorët e përdorimit fundor. Ndërsa, duke mos pasur praktikën e bursës, PD-të në Slloveni mund të përmbushin obligimet e tyre duke bërë një pagesë në 'Eko Fond'.

Bullgaria, në anën tjetër, kishte mjaft vështirësi në fazat e para të zbatimit të skemës për OEE në vitin 2014, kryesisht falë ndikimit të ndërrimit të qeverisë në atë kohë. Ndërsa, kohët e fundit me qartësimin e synimeve, mekanizmat për rikuperimin e kostove dhe procedurat përmbareshme për mospajtueshmëri u arrit të sigurohen investime nga PD-të prej 25 milionë € në 2018 dhe 50 milionë € në 2019-2020. Siç është përcaktuar, PD-të janë të gjithë shpërndarës të energjisë për përdoruesit fundorë përtej një pragu të caktuar (në varësi nga lloji i energjisë), duke përjashtuar lëndët djegëse për transport. Një sërë veprimesh të ndryshme janë miratuar në të gjithë sektorët, për sa kohë që ato mund të dëshmojnë në kursimin e energjisë. Një praktikë e zakonshme e monitorimit të rezultateve janë Auditimet e Energjisë me krahasime para/pas. Në skemën e mëparshme të zbatuar deri në vitin 2016, obligimet u caktuan gjithashtu për kompanitë e mëdha industriale dhe autoritetet publike me përfitimin e shtuar që u mundëson këtyre PD-ve të mëdha të marrin kredi të kursimit të energjisë. Shumica e kursimeve të

---

<sup>32</sup> Pasqyrë e skemave për Obligimin e Eficiencës së Energjisë në Evropë: Azhurnimi i vitit 2017 Punëtorja e Katërt Evropiane e Klubit të Certifikatave të Bardha. 2017

energjisë të raportuara deri më tani janë realizuar në industri.

Gregia në vitin e referimit 2017 ka filluar zbatimin e skemës për OEE që obligon PD-të, siç janë shitësit e energjisë elektrike, gazit dhe produkteve të naftës (LPG, benzinë, naftë dhe vaj për djegie) të paguajnë në një Fond të EE për ta blerë një pjesë të synimit të tyre dhe gjithashtu parasheh ndëshkime për mospajtueshmëri. PD-të e përcaktuara përbëhen nga furnizuesit ose shitësit me pakicë, pjesa e të cilëve në treg është më e madhe se 1% dhe që përfaqëson në total të paktën 95% të energjisë së shitur për secilën lëndë djegëse veç e veç – energji elektrike, gaz. PD-të mund t'i implementojnë vetë projektet, por dhe përmes nën-kontraktimit dhe/ose partneriteteve, ndërsa lejohet edhe shkëmbimi i kursimeve të energjisë midis PD-ve.

Lidhur me Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, nuk ka ende OEE, megjithëse janë ndërmarrë hapa në përgatitjen e tyre.

Në Bosnië dhe Hercegovinë, legjislacioni primar është adoptuar, ndërsa ai dytësor është në formë drafti, akoma nuk është miratuar. OEE përfshihet në PKVEE-në e fundit dhe skema përkatëse ka qenë në zhvillim e sipër tash e 3 vjet me mbështetjen e USAID-it. Është hartuar një udhërrëfyes i nivelit të lartë për OEE, si dhe një udhëzues i detajuar dhe legjislacioni tjetër sekondar lidhur me të<sup>33</sup>.

Magedonia e Veriut më në fund miratoi Ligjin e saj për Efiçencën e Energjisë. Mirëpo, legjislacioni sekondar ekzistues do të duhet të ndryshohet ose nxjerren akte të reja për zbatimin e Ligjit për Efiçencën e Energjisë. Është parashikuar një skemë për OEE në kombinim me masa alternative, por peshat relative midis masave ende nuk janë vendosur.

Serbia ende nuk ka marrë vendim zyrtar në lidhje me qasjen e tij të politikave për Nenin 7 të OEE dhe nëse do të adoptojë një skemë për OEE. Vendi po merr mbështetje nga Programi Rajonal i Efiçencës së Energjisë Plus (PREE Plus) i BERZH-it në këtë proces. Janë duke u shqyrtuar mundësitë si për një Fond të EE ashtu edhe për një skemë për OEE. Pengesat kryesore aktualisht janë mungesa e kapaciteteve ministrore dhe e konkurrencës në tregun e furnizimit me energji elektrike, si dhe kombinimi i çmimeve të ulëta të energjisë elektrike dhe një ekonomie të plogësht.

#### **b) Modele biznesi / skenarë për OEE-të**


Për sa i përket modelit operativ, hulumtimi ka zbuluar se mekanizmi mbizotërues i realizimit të skemave për OEE ka qenë financimi me grante, ku pikë së pari dhe më e rëndësishmja, duhet të sigurohet që mekanizmi i rikuperimit të kostos zbatohet përmes tarifave, meqë kjo është e obligueshme për realizim të suksesshëm, pa këtë – ka hapësirë shumë të kufizuar për realizim të suksesshëm afarist të skemave për OEE<sup>34</sup>. Gjithashtu, skemat për OEE duhet të planifikohen me kujdes dhe të mendohen nga perspektiva e përdoruesit fundor, në kuptim të kalkulimit se sa janë ata të gatshëm të kontribuojnë vetë në mënyrë që të joshen përdoruesit fundorë për të

<sup>33</sup> Skemat e Obligimit për Efiçencën e Energjisë: Udhëzime për politika.

<sup>34</sup> Skemat e Obligimit për Efiçencën e Energjisë: Udhëzime për politika. Analizë e thellë e mekanizmit kryesor të politikave që mund të futet në përdorim sipas Nenit 7 të Direktivës për Efiçencën e Energjisë. Përgatitur bashkërisht nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Shkurt 2019


pranuar masat e efijencës së energjisë<sup>35</sup>.

Siç u përmend më herët, përparësia kryesore e skemave për OEE është potenciali i tyre për t’u përshtatur me kontekstin, kështu që ekziston një sërë modelesh për realizim afarist të aplikuara në të gjithë vendet e BE-së dhe globalisht. Nga kjo, është e mundur të dallohen dy prej këtyre modeleve që në thelb promovojnë atë që njihet si ‘parimi ndotësi paguan’ dhe që kanë potencialin për t’u zhvilluar në kontekstin e Kosovës.



Modeli 1: ‘Administratori i skemës’ përcakton synimet për PD-të dhe më pas PD-të angazhohen drejtpërdrejt me përdoruesin fundor për të identifikuar mundësitë e përbashkëta për investime në masat e efijencës së energjisë. Pastaj PD-të subvencionojnë një pjesë të kostos së investimit (siç është izolimi i ndërtesës), ndërsa përdoruesi fundor kontribuon gjithashtu financiarisht. Kostot rikuperohen përmes tarifave fillestare të rritura dhe normat mesatare të levës janë 2:1. Si opsion, administratori i skemës mund të ketë kompetencat për të kufizuar PD-të nga arkëtimi i një tarife për përdoruesin fundor. Me këtë, administratori i skemës do të ishte përgjegjës për zbatimin e masave të efijencës së energjisë, duke ofruar në këtë mënyrë një burim të besueshëm të të ardhurave.

Figura 6: Paraqitja grafike e Modelit 1: Direkt nga PD që instalon vetë masën EE (mundësisht përmes një njësie subsidiare)



Modeli 2 është i ngjashëm me modelin e mëparshëm, përveç prezantimit të firmave private të instalimit të energjisë si ndërmjetës midis PD-ve dhe përdoruesit fundor në kuptim të ofrimit të këshillave dhe ndërhyrjeve të specializuara. Në këtë mënyrë, PD-të angazhojnë firma të specializuara dhe u ofrojnë atyre grante. Pastaj këto firma më të vogla angazhohen me përdoruesit fundorë në identifikimin dhe zbatimin e masave të efijencës së energjisë. Përdoruesi fundor gjithashtu kontribuon në kostot e investimit, ndërsa përsëri kostoja rikuperohet nga PD-të përmes tarifave fillestare të rritura për një kohë të kufizuar.

<sup>35</sup> Direktiva e BE-së për Efijencën e Energjisë (2012/27/EU): Udhëzues për zbatim të fortë

## 5. PD-të dhe synimet

### a) Energjia: Furnizuesi kundrejt shpërndarësve

Vendimi nëse do të vendoset obligimi mbi furnizuesin ose shpërndarësin lidhet me historinë e efikasitetit të energjisë të shërbimeve komunale, si dhe me kulturën lokale të realizimit të efikasitetit të energjisë dhe statusin lokal të tregut të energjisë, nëse është i liberalizuar ose i integruar vertikalisht. Siç është dokumentuar botërisht, nuk ka rregull fikse se kush duhet të obligohet - të dy qasjet kanë funksionuar. Vlen të përmendet se OEE-të kanë zënë fill me shërbimet e integruara vertikalisht të energjisë elektrike dhe më pas janë zgjeruar te lëndët djegëse të parregulluara të ngrohjes (të tilla si mazuti, ose LPG), lëndët djegëse të ngurta, lëndët djegëse për transportin rrugor, etj.<sup>36</sup>

Ndërsa në Kosovë, 92.3% e furnizimit me energji sigurohet nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), me vetëm 7.7% bazuar në burimet e ripërtëritshme.<sup>37</sup> Ndërkaq, Shërbimet e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike në Kosovë (KEDS) është një kompani që operon në të gjithë Kosovën që ka ekskluzivitetin për shpërndarjen e energjisë elektrike në territorin e Kosovës. Që nga maji i vitit 2013, KEDS u nda nga KEK-u dhe filloi veprimtarinë e saj operacionale si kompani aksionare. KEDS tani është në pronësi të kompanive turke Çalık Holding dhe Limak. Në nëntor 2018, Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës regjistroi një kompani furnizimi Elektroserver, në pronësi të plotë të ndërmarrjes publike Elektroekonomia e Serbisë (EPS). Licencimi i një furnizuesi serb në Kosovë është parakusht për hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Kyçjes ndërmjet ENTSO-E dhe KOSTT<sup>38</sup>.


<sup>36</sup> Lees, E., dhe Bayer, E. (2016, shkurt). Paketa e mjeteve për Obligimet e Efikasitetit të Energjisë. Bruksel, Belgjikë: Projekti i Asistencës Rregullatore. Marrë nga <http://www.raponline.org/document/download/id/8029>

<sup>37</sup> Mundësitë e Kosovës për një Treg të Energjisë: Rasti i Energjisë Elektrike. INDEP, 2015

<sup>38</sup> <https://energy-community.org/implementation/Kosovo.html> (accessed on 06/04/20)

# Electricity Market Structure Map

The energy sector represents the backbone of economic development and is a key political tool towards regional integration. Indeed, how the electricity sector functions also radiates into the way we consume it, the price we pay for it, and the goods and services offered. It also indirectly affects our disposable income for other goods and services. Namely, the more money a household spends on electricity the less it can afford to spend on other things.



Burimi: Mundësitë e Kosovës për një Treg të Energjisë: Rasti i Energjisë Elektrike. INDEP, 2015

Shërbimet e ngrohjes qendrore në Kosovë janë në dispozicion në tri qytete: Prishtinë, Gjakovë dhe Mitrovicë – me mbulim maksimal nga 5-7% të stokut të ndërtesave në ato qytete. Me mbështetjen financiare nga KfW, termocentrali Kosova B është shndërruar në një strukturë të kombinuar të ko-gjenerimit të ngrohjes dhe energjisë për të furnizuar një pjesë të madhe të Prishtinës me ngrohje dhe kështu të rritet përqindja e konsumatorëve të lidhur në rrjetin e ngrohjes qendrore.

## b) Diapazoni i mbulimit me lëndë djegëse

Energjia elektrike ishte PD me automatizëm në të gjitha skemat për OEE, dhe aty ku është e zbatueshme - edhe gazi natyror obligohet gjerësisht. Ndërsa, kohët e fundit furnizuesit dhe shpërndarësit e ndryshëm të lëndëve djegëse janë të obliguar siç tregohet në tabelën më sipër. Vlen të përmendet se kostot e zbatimit të OEE-ve për PD-të ulen në mënyrë të qëndrueshme me ekonomitë e shkallës, kështu që PD-të më të vogla mund të krijojnë vështirësi për shkak të rritjes së kostos për to. Një ilaç i zakonshëm për këtë është përjashtimi i PD-ve më të vegjël derisa ato të arrijnë një përqindje të caktuar të tregut, siç janë shembujt në Francë, Itali, Britani të Madhe.<sup>39</sup> Përndryshe, praktikat në SHBA janë që PD-të më të vogla paguajnë në një fond të përbashkët që grumbullon të gjitha kontributet. Pastaj, administratori i skemës ose një administrator i fondit bën livrimin e kursimeve të energjisë.

## c) Sektorët e përdorimit fundor

Sektorët e disponueshëm të përdorimit fundor janë ata ku kursimet e energjisë mund të llogariten kundrejt OEE të një pale të obliguara. Ekziston një gamë e gjerë e sektorëve të

<sup>39</sup> Lees, E., dhe Bayer, E. (2016, shkurt). Paketa e mjeteve për Obligimet e Eficiencës së Energjisë. Bruksel, Belgjikë: Projekti i Asistencës Rregullatore. Marrë nga <http://www.raponline.org/document/download/id/8029>

disponueshëm të përdorimit fundor dhe këta zakonisht janë sektori rezidencial, komercial, publik, industria, transporti dhe bujqësia. Vendimi për sektorin e përdorimit fundor lidhet me identifikimin e potencialit maksimal të kursimit të energjisë. Sa për ilustrim, tabela më poshtë paraqet sektorët e pranueshëm të përdorimit fundor në BE:

Tabela 1. Sektorët e pranueshëm të përdorimit fundor në BE

Rezidencial (9/9)	Komercial (8/9)	Publik (8/9)	Industria (8/9)	Transporti (6/9)	Bujqësia (5/9)
Austria, Bullgaria, Danimarka, Spanja, Franca, Irlanda, Italia, Lituania, Polonia, Sllovakia, Mbretëria e Bashkuar	Austria, Bullgaria, Danimarka, Spanja, Franca, Irlanda, Italia, Lituania, Polonia, Sllovakia	Austria, Bullgaria, Danimarka, Spanja, Franca, Irlanda, Italia, Lituania, Polonia, Sllovakia	Austria, Bullgaria, Danimarka, Spanja, Franca, Irlanda, Italia, Lituania, Polonia, Sllovakia	Austria, Bullgaria, Danimarka, Spanja, Franca, Irlanda, Italia, Sllovakia	Austria, Bullgaria, Danimarka, Spanja, Franca, Irlanda, Sllovakia

E adaptuar nga: Lees, E., dhe Bayer, E. (2016, shkurt). Paketa e mjeteve për Obligimet e Efiçencës së Energjisë. Bruksel, Belgjikë: Projekti i Asistencës Rregullatore. Marrë nga <http://www.raponline.org/document/download/id/8029>

## 6. Masat e politikave dhe obligimet e kursimit të energjisë sipas sektorëve (disa nga masat e mundshme)

Kur zhvillohet një model për OEE, sektori që do të përzgjidhet duhet të përkufizohet, duke theksuar qartë nëse palët e obliguara mund të arrijnë kursime në të gjithë sektorët ose vetëm në disa. Opsionet përfshijnë: të gjithë sektorët, sektorin rezidencial, sektorin komercial, sektorin industrial, sektorin publik, sektorin e transportit dhe një kombinim të këtyre. Përparësitë dhe mangësitë e këtyre opsioneve janë përmbledhur më poshtë:

	Përparësitë	Mangësitë:
<b>Të gjithë sektorët</b>	Fleksibiliteti për palët e obliguara	Më komplekse sesa përqendrimi në vetëm një ose dy sektorë
<b>Sektori rezidencial</b>	Potencial i madh për masa të thjeshta dhe të përsëritshme për efiçencën e energjisë Për shkak se këta konsumatorë paguajnë shumicën, ata do të kenë përfitimet më të mëdha nga masat e EE Është e mundur të zbatohen procedura të thjeshta për monitorim dhe verifikim	Një numër i madh i aktorëve të përfshirë
<b>Sektori komercial</b>	Numri më i vogël i aktorëve të përfshirë	Masat teknike potencialisht mjaft komplekse Periudhat e shpagimit janë të shkurtra
<b>Sektori industrial</b>	Numri më i vogël i aktorëve të përfshirë	Masat teknike shumë komplekse Periudhat e shpagimit janë të shkurtra
<b>Sektori publik</b>	Numri më i vogël i aktorëve të përfshirë	Masat teknike potencialisht më komplekse Paratë nga donatorët dhe kreditë e buta janë në dispozicion
<b>Sektori i transportit</b>	Reduktimet e emisioneve brenda sektorit zakonisht nuk kontribuojnë aq shumë sa sektorët e tjerë	Masat teknike potencialisht mjaft komplekse Potenciali i kufizuar për masa të përsëritshme të efiçencës së energjisë




Figura 8: Konsumi përfundimtar i energjisë

INDEP rekomandon që Kosova fillimisht të përqendrohet në sektorin e banimit, meqë ky sektor ofron potencial të konsiderueshëm për masa të përsëritshme dhe me kosto të ulët të efijencës së energjisë. Gjithashtu, ndërtesat shtëpiake janë kontribuuesit kryesorë në kërkesën për energji në Kosovë - 36% siç tregohet në Figurën 9. Për më tepër, programet për konsumatorët nga grupet e cenueshme mund të përfshihen në skemën për OEE për të ndihmuar konsumatorët nevojtarë që të reduktojnë përdorimin e tyre të energjisë. Shumica e modeleve për OEE në Evropë kanë realizuar shumicën e kursimeve të tyre të energjisë në sektorin e banimit.<sup>40</sup>

Për të rritur efijencën e energjisë, do të duhej të konsiderohen si prioritet masat e mëposhtme:

- Zhvillimi i strategjive kombëtare për rinovimin e ndërtesave në përputhje me Direktivën e Performancës Energjetike të Ndërtesave;
- Programet për zëvendësimin e shporetëve shtëpiake, izolimin e fasadave dhe zëvendësimin e dritareve dhe ndriçimit joeficient të energjisë;
- Vendosja e programeve afatgjata të financimit me norma të ulëta interesi për investime në rinovimin, modernizimin dhe ndërtimin e godinave rezidenciale, komerciale dhe publike, me standarde të larta të efijencës dhe përdorim të madh të gjenerimit të shpërndarë nga burimet e ripërtëritshme solare, ngrohjes me biomasë, pompave të nxehtësisë (p.sh. siç është zbatuar në Gjermani nga KfW);
- Zhvillimi i strategjive për dekarbonizimin e rrjeteve të ngrohjes qendrore në qytete (replikimi i projektit të ko-gjenerimit të ngrohjes qendrore në Prishtinë);
- Mbështetja e NVM-ve për fabrikimin vendor të teknologjive/pajisjeve me efijencë të energjisë, si dhe të pajisjeve të vogla shtëpiake me energji të ripërtëritshme, për familjet: p.sh. kaldaja efijente me biomasë/biogaz, panele solare të ngrohjes ose pompa ngrohëse/ftohëse;
- Futja e auditimeve të obligueshme të energjisë bazuar në Nenin 7 dhe 8 të Direktivës për Efijencën e Energjisë.<sup>41</sup>

## 7. Sistemi i monitorimit, raportimit dhe verifikimit të kursimeve të energjisë

Ky është një segment thelbësor i zhvillimit të skemave për OEE. Ai përfshin hapat që vendosin

<sup>40</sup> Skica e Skemës për Obligimin e Efijencës së Energjisë për Bosnjën dhe Hercegovinën

<sup>41</sup> Agora Energiewende & Sekretariati i Traktatit të Energjisë | Mbështetja e Tranzicionit të Energjisë në Ballkanin Perëndimor

synimin, rregullat që përcaktojnë kursimin e energjisë dhe procedurat për monitorimin dhe verifikimin që kursimet e energjisë që pretendohen janë materializuar vërtet. Në përgjithësi, duhet të vendosen një sërë rregullash për:

- i. Validimin në tavolinë të masave të instaluar të efijencës së energjisë
- ii. Inspektimet në vend të një mostre të masave të instaluar
- iii. Kontrollin e cilësisë së masave të instaluar

Rolet e monitorimit dhe verifikimit duhet të kryhen nga 'administratori i skemës' dhe ka qasje të ndryshme për projekte të mëdha dhe të vogla. Kontrolli i parë është të sigurohet se nuk ka elemente mashtrimi, për shembull konfirmimi se masat e efijencës së energjisë janë instaluar në të vërtetë. Pastaj për projektet më të mëdha që kanë monitorim të pavarur, ky është një proces mjaft i thjeshtë. Ndërsa, për projektet që kanë përdorur kurse të energjisë së konsideruar, 'administratori i skemës' mund të përdorë metodën e marrjes së mostrave. Me anë të kësaj metode, 'administratori i skemës' do të kontaktojë me objektet e përfituesve për të konfirmuar masat e efijencës së energjisë të deklaruara nga PD. Në këtë pikë, mund të jetë gjithashtu e mundur të mblidhen të dhëna mbi përshtypjet e konsumatorit dhe përmirësimet e mundshme për qasjen. Ndërkohë që bëhet siguri se masat e EE janë instaluar si duhet dhe po arrijnë kënaqshmërinë e konsumatorit meqë kjo është e rëndësishme për përsëritje të biznesit dhe lehtësinë e zhvillimit të projektit në të ardhmen. Përsëri, kjo është një fushë ku është e qartë se shpesh lypset ekspertiza teknike në mënyrë që administratori të vërtetojë nëse kursimet e pretenduara janë vërtet valide.

Nga ana tjetër, do të duhej të merret parasysh se një Platformë e Monitorimit dhe Verifikimit (PMV) e zhvilluar nga GIZ është në zbatim në vendet e tjera të Komunitetit të Energjisë. Kjo është një ueb-platformë novatore, bazuar në një metodologji nga poshtë-lart për llogaritjen e kurseve të energjisë.

## 8. Përfundim

Një skemë e obligueshme për efijencë të energjisë, e dizajnuar në mënyrë të saktë, mund të realizojë me sukses kurse të qëndrueshme të energjisë për shumë vite. Skema e tillë është fleksible dhe mund të projektohet në një larmi mënyrash për të përmbushur nevojat kombëtare, dhe për t'u përshtatur në kombinime të ndryshme të politikave. OEE-të janë përdorur për të realizuar kurse kryesisht përmes azhurnimit të stokut të ndërtesave, zëvendësimit të hershëm të pajisjeve jo-efijente shtëpiake dhe të tjera, si dhe me përmirësimin e proceseve industriale—kurse të efijencës të cilat nuk mbulohen nga standardet dhe rregullimet minimale. OEE-të kanë dhënë kurse të konsiderueshme të energjisë dhe pritet ta bëjnë këtë edhe në të ardhmen. Në total, 15 vende të BE-së tani kanë një OEE, ndërsa shtetet e tjera anëtare nuk kanë adoptuar OEE dhe nuk planifikojnë ta bëjnë këtë. Për më tepër, siç u shtjellua më lart, OEE-të kanë dhënë kurse më të mëdha të energjisë në Danimarkë dhe Mbretërinë e Bashkuar, ku ka pasur shqetësime publike dhe politike lidhur me koston për paguesit e faturave, dhe kjo ndikoi në uljen e niveleve të ambicies për OEE në MB dhe Danimarkë.



Analiza e INDEP e skemave ekzistuese për OEE tregon se shumica e skemave janë rritur gradualisht dhe në mënyrë të qëndrueshme. Përveç synimit të kursimeve, edhe numri i palëve të obliguara (dhe tregjet e lidhura) është rritur me kalimin e kohës. Deri më tani, shumica e skemave u përqendruan në sektorin e banimit, duke promovuar masat me kosto të ulët siç është izolimi i çatave. Kur qëllimi është të keni një skemë me shumë palë aktive, rregullat duhet të jenë të thjeshta, transparente dhe të kuptueshme lehtësisht.

OEE-të janë një rrugë e dëshmuar dhe efektive për të dhënë stimuj për masa të verifikuara, me kosto të ulët, në nivel të tregut masiv. Shumica e vendeve kanë vendosur që janë të nevojshme politika alternative jashtë përgjegjësisë së ndërmarrjeve të shërbimeve komunale për të përmbushur synimin e tyre të kursimit të energjisë. Si OEE-të ashtu edhe qasjet e tjera mund të ofrojnë stimuj për përdoruesit. Rolet e tyre relative kërkojnë analiza të mëtejshme.

Rregulla themelore e vënë në pah me sa duket është që fillimi me marrëveshjet vullnetare dhe përforsimi dhe/ose zgjerimi i tyre i mëvonshëm do të mund të ofronte një pikë të mirë hyrëse në skemat për OEE. Pastaj, skemat më të mëdha gjithëpërfshirëse me sa më shumë PD (të gjitha llojet e mundshme të energjisë për synimet, të gjithë sektorët e përdorimit fundor), ofron shpërndarjen e barrës dhe çel rrugë për qasje fleksible.

Nga ana tjetër, ka rezultate të mira nga përqendrimi brenda një sektori, siç është rasti në Mbretërinë e Bashkuar dhe përqendrimi e saj në sektorin e banimit me kujdes të veçantë social për arritjen e synimeve alternative lidhur me varfërinë energjetike dhe kujdesin për shtëpitë e cënueshme.

Përndryshe, rekomandohet fuqimisht vendosja e një 'faze mësimore' me të gjitha PD-të si një qasje që kërkon konsensus. Me anë të kësaj, ofrohet fleksibilitet në arritjen e pragjeve të caktuara për një vit me rishikimin pasues të planit të veprimit me bashkë-pjesëmarrje, që në fund bën të mundur që PD-të të përshtaten dhe t'i zhvillojnë strategjitë e tyre, ndërsa prania e një faktori stimulues ofron nxitje për zbatimin e masave në ekonomitë e varfra familjare.

Në fund, komunat kanë potencialin për të luajtur rol kyç në diskutimin mbi formën e skemës për shkak të dëshirës së tyre të zjarrtë për të tërhequr dhe për të ruajtur investimet e mundshme të EE në territorin e tyre. Kjo është veçanërisht e rëndësishme nëse ndërmarrjet e ngrohjes qendrore përfshihen në listën e PD-ve, meqë ato janë kryesisht në pronësi të komunës përkatëse.

## 9. Rekomandim

Duke parë përvojat në mbarë botën, sukcesi i OEE-ve nuk përcaktohet nga: kush është PD, si vendosen synimet e kursimit me efikasitet të energjisë dhe cilët janë sektorët ku zbatohen OEE-të. Nga ana tjetër, faktorët e përbashkët për skemat e suksesshme në të gjithë botën janë:

- Hartimi i udhërrëfyesit dhe udhëzuesit të detajuar për OEE
- Vendosja e nivelit modest të synimeve të kursimit me efikasitet të energjisë sipas kontekstit lokal,
- Rritja progresive e niveleve të synuara me kalimin e kohës,
- Mësimi nga praktika – duke reflektuar në fazat e hershme dhe duke ridizajnuar OEE-të në përputhje me rrethanat (p.sh. çdo tre vjet) në mënyrë që ato të jenë më efikasitet dhe

më efektive,

- Zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm të monitorimit për të vlerësuar performancën e OEE-ve. Praktika ka treguar që ky veprim realizohet më së miri nga një palë e pavarur.
- Vendosja e një sistemi efektiv të ndëshkimit në rast të mospajtueshmërisë. Mund të caktohen dy lloje ndëshkimesh: (1) dënime fikse të caktuara paraprakisht; dhe (2) dënime që nuk caktohen paraprakisht, por përshtaten sipas llojit dhe ashpërsisë së mospajtueshmërisë.
- Krijimi i metodave transparente për llogaritjen e kursimeve dhe krijimi i një strategjie efektive të komunikimit.

Në të gjitha rastet e referuara më sipër, me gjithë sukseset e tyre, pengesa kryesore e rritjes së kostos së përgjithshme për përdoruesit fundorë me aplikimin e skemave kanë qenë shqetësimet publike dhe politike në rritje, dhe si pasojë, politikat e rishikuara në vazhdimësi e kanë marrë parasysh këtë. Gjasat janë të mëdha që çdo aplikim i skemës për OEE do të duhet të ballafaqohet me frikën e rritjes së çmimeve të energjisë. Përveç kësaj, çështje të tjera që duhet të konsiderohen ngaqë mund të pengojnë zbatimin e masave alternative në përputhje me kërkesat e Nenit 7 janë:

- Financimi i pamjaftueshëm nga përdoruesit fundorë, KSHE-të dhe vështirësia e qasjes në financa;
- Aktiviteti i tregut të efijencës së energjisë në të kaluarën u përqendrua te rezultatet e arritshme lehtësisht (p.sh. zbatimi i shpejtë i masave me periudha të shkurtra shpagimi);
- Kostoja e lartë publike lidhur me masat fiskale;
- Niveli i ulët i aftësisë teknike të stafit teknik të komunave dhe bankave;
- Mungesa e vetëdijes dhe motivimit për pjesëmarrje nga subjektet publike dhe familjet.

Thjesht, ekzistojnë dy qasje kryesore kur iniciohen OEE-të, të ashtuquajturat periudha mësimore:

- Mësimi nga përvoja ekzistuese e një skeme vullnetare (skema vullnetare është dëshmuar të jetë skemë e suksesshme) për palët e obliguara dhe përmirësimi i sistemit të përgjithshëm të dizajnit në përputhje me rrethanat.
- Gjetja dhe përshtatja e një dizajni të suksesshëm për OEE nga një vend tjetër. Mësimi nga përvoja e vendeve të tjera ndihmon që të mësohet nga gabimet e vendeve të tjera.

Për të menaxhuar mangësitë e politikave, qeveria duhet të ofrojë prova të qëndrueshme se OEE, si një instrument i politikës, do të mundësojë përfitime mjedisore, shoqërore dhe ekonomike për komunitetin. Një qasje e tillë mund të arrihet duke fituar mbështetje nga grupet e konsumatorëve, OJQ-të me mision mjedisor dhe social. Në mënyrë që politika të realizohet me sukses, do të duhet të vihet në lëvizje një fushatë e fortë komunikimi dhe vetëdijesimi.

\*\*\*\*\*

## 10. Referimet

- Plani i Tretë Kombëtar i Veprimit për Efiçencën e Energjisë (PKVEE) në Kosovë
- Neni 7 i Direktivës për Efiçencë të Energjisë: Gjendja aktuale. Punëtori e ENSPOL për Nenin 7 të OEE. Brussels, Belgium Kiela Vilumsone, L., 2015
- Skica e Skemës për Obligimit e Efiçencës së Energjisë për Bosnjën dhe Hercegovinën
- Efektiviteti i Marrëveshjeve Vullnetare të Efiçencës së Energjisë, Raporti Përfundimtar. Frank Klinckenberg (The Policy Partners) Mirjam Harmelink (SQ Consult). 2017
- Skemat e Obliguese për Efiçencën e Energjisë: Udhëzime për politika. Përgatitur bashkërisht nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (redaktuar 2019)
- Skemat për obligimin e efiçencës së energjisë: e ardhmja e tyre në BE. Tina Fawcett & Jan Rosenow & Paolo Bertoldi. 2018. Në dispozicion këtu: <https://link.springer.com/article/10.1007/s12053-018-9657-1> , accessed on 18/06/2020
- Politikat e kursimit të energjisë dhe skemat e Obligimit për Efiçencën e Energjisë, D5.1 Kombinimi i Obligimeve për Efiçencën e Energjisë dhe politikat alternative
- Politikat e kursimit të energjisë dhe Skema e Obligimit për Efiçencën e Energjisë. Raport Përfundimtar. ENSPOL (shtator, 2016).
- Evropa dhe Azia Qendrore: Dokumentet mbi Opsionet e Financimit të Efiçencës së Energjisë për Kosovën. Banka Botërore 2016.
- Fjalor i termave statistikore, OECD 2001
- Udhëzues për zbatim të fortë. Direktiva e BE-së për Efiçencën e Energjisë (2012/27/EU)
- Ligji nr. 06/L-079 për Efiçencën e Energjisë, neni 10/2
- Studimi Kombëtar i Efiçencës së Energjisë në Ndërtesa për Kosovën. Raporti Përfundimtar i Eptisa, 2013
- Raport i auditimit jo ligjor, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm. 2015
- Taksat për përdorimin e energjisë, OECD 2019
- Paketa e mjeteve për Obligimet e Efiçencës së Energjisë. Bruksel, Belgjikë: Projekti i Asistencës Rregullatore. Lees, E., dhe Bayer, E. (2016, shkurt). Marrë nga <http://www.raponline.org/document/download/id/8029>
- Projekti i Asistencës Rregullatore, Praktikant më të mira në hartimin dhe zbatimin e Skemave për Obligimin e Efiçencës së Energjisë, 2012
- Russo, A. C., Rossi, M., Germani, M., & Favi, F. (May, 2018). Direktiva e Etiketimit të Energjisë: kufizimet aktuale dhe udhëzimet për përmirësim. Konferenca e 25-të e CIRP për Inxhinierinë e Ciklit Jetësor, maj 2018, Kopenhagë, Danimarkë.
- Pasqyrë e skemave për Obligimin e Efiçencës së Energjisë në Evropë: Azhurnimi i vitit 2017 Punëtorja e katërt Evropiane e Klubit të Certifikatave të Bardha. 2017
- Mbështetja e Tranzicionit të Energjisë në Ballkanin Perëndimor. Agora Energiewende & Sekretariati i Traktatit të Energjisë
- Mundësitë e Kosovës për një Treg të Energjisë: Rasti i Energjisë Elektrike. INDEP, 2015

- Raporti i Tretë Vjetor nën Direktivën e Eficiencës së Energjisë. Agjencia e Kosovës për Eficiencë të Energjisë, 2019
- Wasserman, N., & Neme, C. (2012). Politikat për arritjen e eficiencës më të madhe të energjisë. Projekti i Asistencës Rregullatore me Energy Futures. Marrë nga: <https://www.raponline.org/wp-content/uploads/2016/05/sleepinglion-nemewasserman-globalproj1-final-2012-oct-16.pdf>

#### Referimet nga interneti

- <https://mzhe-ks.net/sq/traktati-per-themelimin-e-komunitetit-te-energjiise-#.X29jVmgzZPY>  
Qasur më 03/06/2020
- [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/jpa\\_2017\\_040506.07\\_ks\\_eu\\_support\\_to\\_the\\_energy\\_efficiency\\_fund.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/jpa_2017_040506.07_ks_eu_support_to_the_energy_efficiency_fund.pdf)  
Qasur më 03/06/2020
- <https://www.reuters.com/article/brief-contourglobal-says-halted-plans-to/brief-contourglobal-says-halted-plans-to-build-a-500-megawatt-coal-fired-power-plant-in-kosovo-idUSFWN2B91XB>  
Qasur më 03/06/2020
- <https://www.worldbank.org/en/country/kosovo/brief/al-energy-in-kosovo>  
Qasur më 15/06/2020
- [https://ec.europa.eu/info/energy-climate-change-environment/standards-tools-and-labels/products-labelling-rules-and-requirements/energy-label-and-ecodesign/about\\_en](https://ec.europa.eu/info/energy-climate-change-environment/standards-tools-and-labels/products-labelling-rules-and-requirements/energy-label-and-ecodesign/about_en)  
Qasur më 05/06/2020
- [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/e%2Bn/MEMO\\_19\\_1596](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/e%2Bn/MEMO_19_1596)  
Qasur më 05/06/2020
- <https://energy-community.org/implementation/Kosovo.html>  
Qasur më 06/04/2020

\*\*\*\*\*

